



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 27

Tiranë – E hënë, 20 shkurt 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 7.2.2017	1931
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 7.2.2017	1937
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 7.2.2017	1943

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 13.2.2017	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 259, datë 5.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. 849, datë 11.4.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2015-468, datë 26.2.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; - Pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 259, datë 5.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; - Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.....	1952
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 13.2.2017	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-3261 (470), datë 18.9.2014 të Gjykatës së Lartë.....	1959
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 15.2.2017	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-1269, datë 14.7.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi); - Pezullimin e ekstradimit të shtetasit Afrim Tarelli deri në një vendimarrje të drejtë dhe përfundimtare të çështjes.....	1962



**VENDIM**  
**Nr. 7, datë 7.2.2017**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 6.12.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 75/14 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Zana Harxhi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “Petrolimpeks” sh.a., Ministria e Financave, Shoqëria “Resuli-Er” sh.a.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-3078(369), datë 16.9.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 21 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, që është shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Financave dhe shoqërisë “Resuli-Er”, sh.a., që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore rezulton se pala paditëse, midis tyre edhe kërkuësja (Tahire Daja, Ismail Reka, Lirie Lacej, Arben Baroni, Njazi Reka, Zana Harxhi,

Florjan Reka, Vjollca Reka, Artan Reka, Mimoza Lazri, Lavdiye Reka e Speranca Reka), janë trashëgimtarë ligjorë të ish-pronarëve Hysni Reka dhe Hajredin Reka.

2. Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave Tiranë, me vendimin nr. 374, datë 25.4.1994, midis të tjerave, u ka njohur atyre pronësinë mbi një sipërfaqe trualli prej 730 m<sup>2</sup> (mbi të cilën ndodhej një depo e benzinatës e cisternës) dhe një sipërfaqe tjetër trualli prej 475 m<sup>2</sup> (sipërfaqe e përfshirë në totalin prej 796 m<sup>2</sup> sipas pikës 3 të vendimit që përcakton njohjen e pronësisë mbi truallin e lirë), të ndodhura te Zogu i Zi, Tiranë. Këtë pronësi trashëgimtarët e kanë regjistruar në hipotekë me nr. 2604, datë 30.6.1994.

3. Në të njëjtën kohë rezulton se pronësia objekt gjykimi është konfirmuar edhe me një vendim tjetër të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë dhe konkretisht me vendimin nr. 549, datë 3.5.1996. Edhe në këtë vendim flitet për njohje të pronësisë për sipërfaqen objekt gjykimi. Vlen të përmendet se ky vendim referon së pari në një vendim gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 2905, datë 16.4.1996, sipas të cilit është vendosur anulimi i pjesshëm i vendimit nr. 374, datë 25.4.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë për pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi (*sipërfaqja e depove të cisternës ka qenë pika 2 e vendimit - 730 m<sup>2</sup> - pjesa tjetër nga sipërfaqja totale prej 805 m<sup>2</sup> ka qenë pika 3 e vendimit të vitit 1994*). Në vendimin nr. 549, datë 3.5.1996 parashikohet shprehimisht se sipërfaqja që do të trajtohet është 8860 m<sup>2</sup>, pasi për 1910 m<sup>2</sup> te Parku i Autobusëve dhe 730 m<sup>2</sup> të zëna nga benzinata e cisternës mbetet në fuqi vendimi i vitit 1994. Në pjesën urdhëruese të këtij vendimi, për sa i takon sipërfaqes prej 730 m<sup>2</sup>, citohet se “*u njihet pronarëve*”.

4. Sipërfaqja e truallit prej 805 m<sup>2</sup> është poseduar nga të paditurit, fillimisht nga e paditura shoqëria “Petrolimpeks” sh.a. dhe më pas gjatë gjykimit në gjykatat e faktit nga e paditura tjetër shoqëria “Resuli-Er” sh.a., duke e vënë në pamundësi palën paditëse për të gëzuar pronën e saj. Në vitin 1996, Ministria e Financave këtë truall me sipërfaqe 805 m<sup>2</sup> e ka trajtuar si pronë shtetërore dhe ka vendosur kalimin e saj nga pronë shteti në asete të të



paditurës, shoqërisë “Petrolimpeks” sh.a., me anë të formës së privatizimit. Në këtë aspekt rezulton e provuar se e paditura në këtë gjykim, shoqëria anonime “Petrolimpeks” sh.a., është krijuar nga aksioneri shtet (Ministria e Financave) në datën 27.5.1995 në bazë të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjes shtetërore në shoqëri tregtare”. Rezulton se më pas, me urdhrin nr. 2/19, datë 26.10.1995 të ministrit të Financave, në cilësinë e aksionerit të vetëm, është vendosur privatizimi i kësaj shoqërie si më lart nëpërmjet shitjes së 49% të aksioneve të kapitalit të “Petrolimpeks” sh.a. te personat e tretë (ish-punonjës të shoqërisë) nëpërmjet ankandëve të zhvilluara në datat 20.11.1995 dhe 20.12.1995, pasqyruar edhe në regjistrin tregtar me vendimin gjyqësor nr. 11973/2, datë 9.9.1996. Për rrjedhojë, shoqëria në fjalë nga ky moment kishte si aksionere Ministrinë e Financave me 51% të aksioneve dhe 278 aksionerë privatë me 49% të aksioneve.

5. Ministria e Financave me urdhrin nr. 29/1 prot, datë 29.1.1996 ka vendosur zmadhimin e kapitalit themeltar të të paditurës shoqërisë “Petrolimpeks” sh.a., duke futur në këtë kapital themeltar edhe vlerën e një sërë trojesh dhe objektesh të shtetit, që në total arrinte në shumën prej 121,025.552 lekësh. Ndërkaq, rezulton se pikërisht në këtë shtesë Ministria e Financave ka futur edhe sipërfaqen prej 805 m<sup>2</sup> objekt gjykimi. Trualli objekt gjykimi me sipërfaqe prej 805 m<sup>2</sup> është bërë pjesë e aksioneve prej 51% që zotëronte Ministria e Financave në shoqërinë “Petrolimpeks” sh.a., që ka sjellë më pas përfshirjen e truallit objekt gjykimi në procesin e privatizimit (*shitjes*) së pjesës prej 51% të aksioneve të aksionerit shtet.

6. Në datën 11.12.2012, pala e paditur, shoqëria “Petrolimpeks” sh.a., i ka shitur truallin objekt gjykimi shoqërisë “Resuli-Er” sh.a. (në cilësinë e blerëses) me kontratën e shitjes nr. 4855 rep, 2057/1 kol, datë 11.12.2012. Konkretisht, sipas kësaj kontrate, është shitur një stacion shitje karburanti, një godinë njëkatëshe dhe depozita nëntokësore me sipërfaqe ndërtimore 325 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale trualli prej 806 m<sup>2</sup>. Pala paditëse, duke pretenduar se veprimet juridike të mësipërme janë absolutisht të pavlefshme, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadinë objekt gjykimi.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5738, datë 23.5.2013, ka vendosur: “*Pranimin e padisë. Detyrimin e të paditurve shoqërisë “Petrolimpeks” sh.a., shoqërisë “Resuli Er” sh.a. dhe Ministrisë së Financave për të njohur pronar palën paditëse mbi një sipërfaqe trualli prej 805 m<sup>2</sup> të njohur me vendimin nr. 374, datë 25.4.1994 të K.K.K.Pronave ish-pronarëve Tiranë (pika 2 dhe 3) dhe të regjistruar më pas në hipotekë me nr. 2604, datë 30.6.1994, si dhe detyrimin gjithashtu të këtyre të paditurve për t’i liruar dhe dorëzuar sipërfaqen si më lart të truallit prej 805 m<sup>2</sup> palës paditëse.*”.

8. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2823, datë 26.6.2014, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 5738, datë 23.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*”.

9. Kundër vendimit nr. 2823, datë 26.6.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të nenit 472 të KPC-së, ka ushtruar rekurs pala e paditur shoqëria “Petrolimpeks” sh.a. dhe shoqëria “Resuli Er” sh.a.

10. Kundër vendimit nr. 2823, datë 26.6.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë është ushtruar rekurs. Kolegji Civil, me vendimin nr. 00-2015-3078(369), datë 16.9.2015, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 5738, datë 23.5.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe të vendimit nr. 2823, datë 26.6.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësvë.*”.

## II

11. **Kërkuesja** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të kërkesës, duke pretenduar se është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka dalë tej kompetencave të veta duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve të administruara nga gjykatat më të ulëta. Sipas saj, Kolegji Civil ka vlerësuar ndryshe nga gjykatat e tjera, se paditësit nuk janë pronarë, pasi prona vetëm u është njohur dhe nuk u është kthyer.

12. **Subjekti i interesuar, Ministria e Financave**, ka paraqitur me shkrim se pretendimi i kërkueses se Kolegji Civil ka dalë tej kompetencave, pasi ai Kolegji ka shqyrtuar provat dhe faktet e administruara nga gjykatat më të ulëta dhe në fund ka konstatuar se ato nuk e kanë zbatuar drejt ligjin, është i pabazuar. Kjo vendimarrje është tërësisht në përputhje me



natyrën e gjykimit të Gjykatës së Lartë, e cila ka në funksion të kontrollojë zbatimin e drejtë të ligjit nga gjykatat më të ulëta.

13. *Subjekti i interesuar, shoqëria "Resuli-Er" sh.a.*, ka prapësuar me shkrim se pretendimi i kërkuësës nuk është i bazuar. Sipas saj, është në natyrën e Gjykatës së Lartë që të ketë edhe funksion revizionues. Kjo gjykatë nuk bën gjykim të ri, por hedh dritë mbi mënyrën se si gjykatat e ulëta e kanë zbatuar ligjin. Kjo ka ndodhur edhe në rastin në gjykim. Gjykata e Lartë mbi bazën e fakteve dhe provave ka zbatuar siç duhet të drejtën dhe ligjin.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësës

14. Gjykata çmon se kërkuësja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

15. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuësja, *prima facie*, legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimi i ngritur prej saj hyn në juridiksionin kushtetues. Pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj shqyrtohet në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

16. Kërkuësja pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë një interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një "gjykatë e caktuar me ligj". Zbatimi i këtij parimi ka gjetur trajtim nga kjo Gjykatë edhe lidhur me funksionin rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se procesi konsiderohet i rregullt, në

kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Gjykata e Lartë mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë themelin e çështjes për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në këto raste kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Për këtë arsye, Gjykata është shprehur se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi për themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Bazuar në këto standarde, Gjykata është shprehur se nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, i trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr. 44, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, dhe si të tilla nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një



proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (shih vendimin nr. 2, datë 26.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosë prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojë njëkohësisht vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta (shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Referuar vendimit të Kolegjit Civil objekt kërkesë, arsyetohet se : “Kjo palë (kupto: kërkuuesja) nuk ka pretenduar se i është shkelur e drejta reale e parablerjes e njohur në vendimin nr. 374, datë 25.4.1994 dhe për rrjedhojë, nëpërmjet gjykimit të mosmarrëveshjes të realizojë ushtrimin e kësaj të drejte (kundërshtimi i procedurave të privatizimit të së drejtës shtetërore). Pala paditëse nuk ka pretenduar se nuk ka mundur të ushtrtojë të drejtën e saj që të marrë aksione në shoqërinë që privatizohet apo të privatizojë objektin, në përpjesëtim të vlerës së truallit të njohur, në bazë të vendimit përkatës të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por kjo palë pretendon se, është pronare e truallit objekt gjykimi dhe për rrjedhojë, kërkon lirin dhe dorëzimin e truallit prej 806 m<sup>2</sup> nga shoqëria “Resuli-Er” sh.a., duke e konsideruar si posedues jo pronar. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke marrë shkas nga pretendimet e palës paditëse, si dhe arsyetimit të gjykatave të faktit, vlerëson se në rastin konkret çështjet juridike të cilat duhet të shtrohen për diskutim, me qëllim saktësimin e natyrës së mosmarrëveshjes janë: (i) nëse palës paditëse, së cilës nuk i është kthyer

sipërfaqja e truallit objekt konflikti gjyqësor, por vetëm i është njohur kjo pronë, a ka interes të ligjshëm për të ngritur padinë për lirin dhe dorëzimin e sendit, si dhe në këto kushte; (ii) nëse mundet pala paditëse të kërkojë konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik të kryer nga të tretët... Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në lidhje me aspektin formal procedural të vlefshmërisë së padisë vlerëson të theksojë se padia që të jetë e vlefshme duhet të plotësojë dy kushte themelore: (a) interesi i ligjshëm për të ngritur padi; dhe (b) legjitimiteti për të vepruar. Në rast se ekzistojnë këto dy kushte mund të konsiderohet që padia ekziston në kuptimin që për gjykatën del domosdoshmëria për të marrë vendim mbi themelin e saj, pra për ta pranuar ose rrëzuar atë. Interesi për të ngritur padi parashikohet qartë në nenin 32 të KPC-së. Në këtë kuadër, është e domosdoshme të verifikohen nga gjykata që në fillim të procesit gjyqësor. Mosekzistenca e njërit prej këtyre kushteve themelore të përmendura më sipër sjell si pasojë që padia të mos ekzistojë, dhe gjykata të marrë vendim për rrëzimin e saj... Kolegji Civil vlerëson se mbrojtja juridike i takon asaj pale që ka të drejtë dhe jo atij që pretendon një të drejtë që nuk ekziston. Pikërisht për këtë qëllim, pala, së cilës i është cenuar një e drejtë, i drejtobet gjykatës me padi. Pala paditëse ka të drejtë që në çdo moment që do të ketë një interes të ligjshëm dhe çmon se ky interes i është i cenuar (kur të fitojë titullin e pronësisë mbi këtë sipërfaqe truall objekt gjykimi), t’i drejtobet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të cenuara, si dhe rivendosjen e tyre. Vetëm kur pala paditëse të ketë interes të ligjshëm për të ngritur padi mund të kërkojë konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike të lidhura midis palëve të treta dhe konkretisht kontratës nr. 4855 rep, nr. 2057/1 Kol, datë 11.12.2012, lidhur ndërmjet shoqërisë “Petrolimpkes” sh.a. dhe shoqërisë “Resuli-Er” sh.a. Pala paditëse mund të përdorte të gjitha mjetet e nevojshme për mbrojtjen e së drejtës së pronësisë së njohur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por kurrësi këtë normë juridike (padinë e rivendikimit), pasi ashtu siç parashtruar më lart nuk ka titull pronësie.”.

22. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil nuk ka marrë as prova të reja dhe as nuk ka i vlerësuar ndryshe provat e administruara nga gjykatat më të ulëta. Vetë gjykatat më të ulëta kanë pranuar se kërkueses nuk i është kthyer prona por vetëm i është njohur. Po kështu referuar dhe objektit të padisë kuptohet që pala paditëse pranon se ajo nuk është pronare me të drejta të plota e pronës. Në këto kushte, Kolegji



Civil duke vlerësuar provat dhe faktet e administruara nga gjykatat ka arritur në përfundimin se kërkuesja nuk legjitimohet të kërkojë kthimin e sendit, pronar i së cilës ajo nuk është ende.

23. Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa është e pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari

#### MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuese shtetasen Zana Harxhi Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Shumica ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkueses se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë një interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, nuk është i bazuar. Sipas shumicës, Kolegji Civil nuk ka marrë prova të reja dhe as nuk ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave të administruara nga gjykatat më të ulëta. Vetë gjykatat më të ulëta kanë pranuar se kërkueses nuk i është kthyer prona, por vetëm i është njohur. Po kështu, sipas shumicës, referuar edhe objektit të padisë, kuptohet se pala paditëse pranon se ajo nuk është pronare me të drejta të plota e pronës. Në këto kushte, Kolegji Civil, duke vlerësuar provat dhe faktet e administruara nga gjykatat, ka arritur në përfundimin se kërkuesja nuk legjitimohet të kërkojë kthimin e sendit, pronare e së cilës ajo nuk është ende (*shih paragrafin nr. 22 të vendimit*).

2. Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se Gjykata e Lartë nuk ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj ligjore dhe nuk ka respektuar standardin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për rrjedhojë kërkesa e shtetasës Zana Harxhi duhet pranuar për arsytet e mëposhtme.

3. Parimi i gjykatës së caktuar me ligj është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës. Lidhur me vlerësimin e provave nga Gjykata e Lartë, sikurse thekson edhe shumica në vendimin e saj (*shih paragrafët nr. 17-20 të vendimit*), kjo e fundit jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por, gjithashtu, nuk mund të vlerësojë ndryshe provat e vlerësuara nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe të rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit apo t'i ndryshojë ato (*shih vendimet nr. 53, datë 20.7.2015; nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se procesi konsiderohet i rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Gjykata e Lartë mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë themelin e çështjes për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në këto raste, kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Për këtë arsye, Gjykata është shprehur se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Bazuar në këto standarde, Gjykata është shprehur se nxjerrja e përfundimeve të kundërta lidhur me vlerësimin e provave nga gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta (*shih vendimin nr. 44, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).



6. Sipas jurisprudencës së Gjykatës nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, i trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr. 44, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në rastin në shqyrtim, nga aktet bashkëlidhur kërkesës, ne gjyqtarët në pakicë vërejmë se në arsyetimin e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka vlerësuar provat e paraqitura në gjykim (aktet administrative të pakontestuar) ka arritur në përfundimin se paditësit në atë gjykim, midis të cilëve edhe kërkuësja, janë pronarë të sipërfaqes së truallit të pretenduar (*shih f. 5 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*). Kjo rrethanë konfirmohet edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 2823, datë 26.6.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5738, datë 23.5.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se “... duke marrë shkas nga pretendimet e palës paditëse, si dhe arsyetimit të gjykatave të faktit, vlerëson se në rastin konkret çështjet juridike të cilat duhet të shtrohen për diskutim, me qëllim saktësimin e natyrës së mosmarrëveshjes janë: (i) nëse palës paditëse, së cilës nuk i është kthyer sipërfaqja e truallit objekt konfliktit gjyqësor, por vetëm i është njohur kjo pronë, a ka interes të ligjshëm për të ngritur padinë për lirin dhe dorëzimin e sendit, si dhe në këto kushte; (ii) nëse mundet pala paditëse të kërkojë konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik të kryer nga të tretët... Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në lidhje me aspektin formal procedural të vlefshmërisë së padisë vlerëson të theksojë se padia që të jetë e vlefshme duhet të plotësojë dy kushte themelore: (a) interesi i ligjshëm për të ngritur padi; dhe (b) legjitimiteti për të vepruar. Në rast se ekzistojnë këto dy kushte mund të konsiderohet që padia ekziston në kuptimin që për gjykatën del domosdoshmëria për të marrë vendim mbi themelin e saj,

*pra për ta pranuar ose rrëzuar atë. Interesi për të ngritur padi parashikohet qartë në nenin 32 të KPC. Në këtë kuadër, është e domosdoshme të verifikohen nga gjykata që në fillim të procesit gjyqësor. Mosekzistenca e njërës prej këtyre kushteve themelore të përmendura më sipër sjell si pasojë që padia të mos ekzistojë, dhe gjykata të marrë vendim për rrëzimin e saj... Kolegji Civil vlerëson se mbrojtja juridike i takon asaj pale që ka të drejtë dhe jo atij që pretendon një të drejtë që nuk ekziston. Pikërisht për këtë qëllim, pala, së cilës i është cenuar një e drejtë, i drejtohet gjykatës me padi. Pala paditëse ka të drejtë që në çdo moment që do të ketë një interes të ligjshëm dhe çmon se ky interes i është i cenuar (kur të fitojë titullin e pronësisë mbi këtë sipërfaqe truall objekt gjykimi), t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të cenuara, si dhe rivendosjen e tyre. Vetëm kur pala paditëse të ketë interes të ligjshëm për të ngritur padi mund të kërkojë konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike të lidhura midis palëve të treta dhe konkretisht kontratës nr. 4855 rep, nr. 2057/1 Kol, datë 11.12.2012, lidhur ndërmjet shoqërisë “Petrolimpkes” sh.a. dhe shoqërisë “Resuli-Er” sh.a. Pala paditëse mund të përdorte të gjitha mjetet e nevojshme për mbrojtjen e së drejtës së pronësisë së njohur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por kurrsesi këtë normë juridike (padinë e rivendikimit), pasi ashtu siç parashtroam më lart nuk ka titull pronësie.” (shih paragrafin nr. 21 të vendimit të shumicës).*

9. Jemi të mendimit se nëpërmjet arsyetimit të mësipërm Gjykata e Lartë, në mënyrë të sforcuar, nuk ka mundur t'i shpëtojë vlerësimit të provave që janë në themel të çështjes lidhur me problemin themelor nëse kërkuësja është ose jo pronare e sipërfaqes së truallit, gjë për të cilën si gjykata e shkallës së parë ashtu edhe ajo e apelit janë shprehur pozitivisht. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë edhe pse në dispozitiv ka përdorur fjalën “ndryshim vendimi”, duke ju referuar shkronjës “d” të nenit 485 të KPC-së, *de facto* ai i ka prishur vendimet e gjykatave të faktit dhe ka rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuësës, duke shqyrtuar në këtë mënyrë themelin e çështjes, në tejkalim të kompetencave të sanksionuara në nenin 141 të Kushtetutës, në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk mund të ndryshojë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet për themelin e çështjes, siç ka vepruar edhe në çështjen në fjalë, pasi në të gjitha rastet e





parashikuara nga neni 485 i KPC-së prishja e vendimit të gjykatave të faktit lidhet me rikthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë (shih nenin 485, shkronjat “b”, “c” dhe “ç”). Ky qëndrim i ligjvënësit mendojmë se është në të njëjtën linjë edhe me rolin e Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Në të kundërt, nëse Gjykata e Lartë do ta prishte vendimin dhe do të shqyrtonte themelin e çështjes, ajo nuk do të mund t'i shmangej vlerësimit të provave, gjë që do ta kthente atë në gjykatë fakti të shkallës së tretë, duke kompromentuar në këtë mënyrë rolin dhe misionin e saj.

11. Në vlerësimin tonë kompetencën që ligjvënësi ia ka njohur Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për të ndryshuar vendimet e shkallës së parë dhe të apelit, ai e ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar, si nga pikëpamja literale, ashtu edhe kushtetuese, duke e shndërruar veten nga gjykatë ligji në gjykatë fakti. “Ndryshimi”, në kuptim të shkronjës “d” të nenit 485 të KPC-së, lidhet me ndreqjen, plotësimin ose korrigjimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë apo të apelit, pa shqyrtuar në asnjë rast themelin e tyre (rrezimin apo pranimin e padisë). Prandaj mendojmë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj edhe në këtë aspekt.

12. Si përfundim, mendojmë se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuueses të drejtën për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

Anëtarë: Vitore Tusha, Vladimir Kristo

**VENDIM**  
**Nr. 8, datë 7.2.2017**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Gani Dizdari	anëtar	i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar	i	“	“
Fatos Lulo	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 3.11.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 60/5 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Apelit Durrës

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Kontrolli i pajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i:

- nenit 469/4 të Kodit Civil të vitit 1929 (pasoja që prodhon ende) me këtë përmbajtje: “Por në rast që fëmijët e adoptuem ose të paslindurit e tyre konkurrojnë me të atin ose me amën e adoptuesit, ose me të dy bashkë, këta të fundit trashëgojnë një të tretën, dhe kur konkurrojnë me motrën ose me vëllamë e adoptuesit ose me të dy bashkë, trashëgojnë një të katërtën.”.

- nenit 486, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Kodit Civil (pasoja që prodhojnë ende) me këtë përmbajtje: “Kur bashkëshorti lë fëmijë legjitimë, bashkëshorti tjetër merr si trashëgim uzufuktin e një pjese trashëgimore baras me atë të secilit fëmijë, duke u llogaritur edhe bashkëshorti vetë në numrin e fëmijëve. Në qoftë se me bashkëshortin konkurrojnë fëmijë natyralë dhe legjitimë, uzufukti i bashkëshortit asht një pjesë baras me atë që i takon secilit nga fëmijët legjitimë. Kjo pjesë uzufukti në asnjë rast nuk mundet me qenë ma e madhe se ¼ e trashëgimit, dhe mund të shpërblehet në mënyrën e caktueme në nenin 548.”

BAZA LIGJORE: Nenet 18/2, 41/2, 54/2, 131/a, 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 68 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të gjykatës referuese, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, që ka kërkuar rrezimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Gjykata e Apelit Durrës (në vijim “gjykata referuese”) është vënë në lëvizje pas kthimit për rigjykim të çështjes civile me palë paditëse H.H.



dhe të tjerë, me objekt: “1. *Sigurimi i padisë duke detyruar të paditurit të mos kryejnë veprime juridike në pronat objekt padie.* 2. *Detyrimi i të paditurve të na njohin ne paditësit si bashkëpronarë në ish-pronat e trashëgimlënësit tonë të përbashkët H.M., të njohura dhe të kthyer me vendimet nr. 930, datë 20.6.1995 e nr. 930/1, datë 23.9.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave, me vendimin nr. 2173, datë 5.7.1994.* 3. *Detyrimi i të paditurve të na njohin bashkëpronarë dhe për ndërtimet e ngritura mbi tokën truall, objekt i kësaj padie, për pasuritë trashëgimore të fituar nga trashëgimlënësi ynë H.M., të ndodhura në zonën kadastrave nr. 8512.* 4. *Detyrimi i ZRPP-së Durrës të na regjistrojë si bashkëpronarë në pjesët takuese të përcaktuara në dëshminë e trashëgimisë, të çelur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 1858, datë 11.7.2007, në pasurinë e paluajtshme objekt i kësaj padie, të cilat figurojnë të regjistruara në emër të të paditurve.* 5. *Rregullimi i pasojave juridike duke konstatuar të pavlefshme veprimet juridike kontratat e dburimit nr. 6322rep, nr. 4801kol, datë 9.11.1996 dhe nr. 6320 rep, nr. 4799kol, datë 9.11.1996.* 6. *Detyrimi i të paditurve të na kthejnë pjesën tonë takuese të parave të fituara nga shitjet e ndërtimeve të ngritura mbi trojet me sipërfaqe 4500 m<sup>2</sup> dhe 1470 m<sup>2</sup> sipas pjesëve të përcaktuara në dëshminë e trashëgimisë...në pasurinë e paluajtshme objekt i kësaj pasurie, të cilat kanë pas figuruar të regjistruara në emër të të paditurve si pasuri trashëgimore.”*

2. Sipas parashtrimeve të gjykatës referuese mosmarrëveshja objekt gjykimi ka lidhje me përcaktimin e rrethit të trashëgimtarëve të trashëgimlënësit Hysen Myshketa dhe të pjesëve takuese të tyre. Nga rrethanat e çështjes rezulton se trashëgimlënësi Hysen Myshketa ka vdekur në vitin 1943 dhe ka lënë si trashëgimtarë të tij gruan Aishe dhe djalin Isa Mushketa, të adoptuar në vitin 1939. Dëshmia e trashëgimisë ligjore është çelur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në vitin 1983, duke përcaktuar si trashëgimtar të radhës së parë djalin Isa Myshketa. Nga viti 1995 e në vazhdim, me vendim të KKKP-së Durrës, pasuritë e trashëgimlënësit H. Myshketa i janë kthyer djalit të adoptuar, Isa, i cili ua ka dhuruar të gjitha fëmijëve të tij me kontratat e dhurimit nr. 6320/4799, datë 9.11.1996, nr. 6321/4800, datë 9.11.1996 dhe nr. 6322/4801, datë 9.11.1996.

3. Trashëgimtarët e Veli Myshketës dhe Mehmet Myshketës (vëllezër të Hysen

Myshketës), me pretendimin se edhe ata janë trashëgimtarë të H. Myshketës, pasi janë thirrur në trashëgimi si trashëgimlënës të trashëgimtarëve të tyre, kanë kërkuar njohjen si bashkëpronarë në të gjitha pasuritë sipas objektit të padisë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 2178, datë 29.7.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësve dhe të ndërhyrësve kryesorë si të pabazuar në ligj e prova.

5. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 173, datë 23.2.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 246, datë 11.5.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues.

7. Në seancën e datës 3.5.2016 mbrojtësit e të paditurve në procesin civil kanë paraqitur kërkesë për pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e materialeve Gjykatës Kushtetuese. Gjykata referuese, në seancën e datës 19.5.2016, pasi mori në shqyrtim kërkesën e mësipërme dhe duke konstatuar se nenet 469/4, 486/1/2/3 dhe 487 të Kodit Civil të vitit 1929, që janë normat e zbatueshme, referuar përcaktimit të nenit 318/2 të Kodit Civil në fuqi, bien në kundërshtim me nenet 18/1, 41/2 dhe 54/2 të Kushtetutës, me nenin 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, vendosi pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave të mësipërme.

## II

8. **Gjykata referuese** ka kërkuar kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 469/4 dhe 486/1/2/3 të Kodit Civil të vitit 1929 me argumentin se edhe pse janë pjesë e një ligji të shfuqizuar, ato sjellin ende pasoja kur thirren për zbatim sipas nenit 318/2 të Kodit Civil aktual. Në mënyrë të përmbledhur kërkesja parashtron si vijon:

8.1 Normat e kundërshtuara kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, pasi për përcaktimin e rrethit të trashëgimtarëve Gjykata e Apelit Durrës është e detyruar të zbatojë ligjin e



kohës, detyrim i cili buron nga neni 318/2 i KC-së në fuqi, sipas të cilit trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur. Trashëgimlënësi ka vdekur në vitin 1943, për rrjedhojë ligji i zbatueshëm në atë kohë ishte Kodi Civil i vitit 1929, për zbatimin e të cilit është shprehur edhe Gjykata e Lartë në vendimin nr. 246, datë 11.5.2015.

8.2 Kontrolli i kushtetutshmërisë së një norme të shfuqizuar, siç është edhe rasti konkret, është pranuar nga jurisprudenca kushtetuese europiane, ajo e GJEDNJ-së, si dhe jurisprudenca kushtetuese shqiptare në vendimin nr. 2, datë 31.1.2003.

8.3 Nenet 469, paragrafi 4, dhe 486, paragrafët 1, 2 dhe 3, bien ndesh me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, referuar nenit 18/1 të Kushtetutës, nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 41/1 të Kushtetutës, si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Konkretisht neni 469/4 nuk e njeh si trashëgimtar të vetëm fëmijën e birësuar të trashëgimlënësit bazuar vetëm në shkakun e lindjes së tij jashtë martesë, çka krijon pabarazi ndërmjet fëmijëve të lindur nga martesë me fëmijët e lindur jashtë martesë, për sa u takon të drejtave të tyre për të përfutur nga pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit. Diskriminimi i fëmijës së birësuar rezulton edhe për faktin se ai, edhe pse legjitim, konkurron me shkallën e dytë (prindërit e trashëgimlënësit) merr 2/3 e pasurisë, kurse konkurron me shkallën e tretë (vëllezërit e motrat) merr 1/4 e pasurisë.

8.4 Sipas nenit 486, paragrafët 1, 2 dhe 3, bashkëshortja pasjetuese e Hysen Myshketës nuk konsiderohet si anëtare e familjes, pasi nuk ka drejtë të trashëgojë pasurinë e bashkëshortit të saj nëse nga kjo martesë ka pasur fëmijë legjitimë. Ndërsa vëllezërit e motrat e bashkëshortit të saj kanë të drejtë të përfitojnë nga pasuria e tij, e vetmja e drejtë që gëzon bashkëshortja është uzufukt, të cilin e përfiton jo plotësisht.

8.5 Parashikimet ligjore të kundërshtuara nuk arrijnë të vendosin balancë midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet, pasi në këtë rast mjeti është vetë ligji, ndërsa qëllimi nuk duket se ekziston. Edhe sikur rregullimet ligjore të kenë pasqyruar realitetin e kohës, ato janë shumë të ndryshme nga realiteti i sotëm, si nga ana sociale, ashtu edhe ajo ligjore. Gjykata e

Apelit Durrës, bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, nuk mund të mos marrë parasysh faktin se çështja nuk mund të zgjidhet pa iu referuar ndryshimeve të thella sociale, ligjore e ekonomike. Prandaj ajo, duke pasur parasysh që si Kushtetuta në nenet 18 dhe 54, ashtu edhe Kodi Civil i vitit 1994 nuk bëjnë trajtim të diferencuar të dy kategorive të fëmijëve, nuk mund ta zgjidhë këtë çështje vetëm sipas dispozitave të Kodit Civil të vitit 1929. Për më tepër, nëse Gjykata Kushtetuese do të shfuqizojë normat e kundërshtuara, çështja do të ketë një zgjidhje të ndryshme nga ajo që mund të jepet në rast zbatimi të dispozitave aktuale.

8.6 Interpretimi pajtues i normave ligjore të kundërshtuara është i pamundur, për faktin se ato nuk lënë hapësira për interpretim, pasi rregullimi ligjor është kategorik për sa i takon veçimit të fëmijës së birësuar në raport me atë të lindur nga martesë në të drejtat trashëgimore.

9. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, edhe pse është njoftuar rregullisht, nuk ka paraqitur komente me shkrim brenda afatit ligjor.

10. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar me shkrim si vijon:

10.1 *Në lidhje me legjitimitetin*: gjykata referuese nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues për këto arsye: (i) Parashtrimet e saj janë sa të paqarta, aq dhe kontradiktore. Parashikimi i bërë nga neni 318 i Kodit Civil ka karakter urdhërues dhe synon rregullimin e pasojave në një moment të caktuar, atë të vdekjes së trashëgimlënësit, dhe në këtë kuptim nuk kemi detyrime periodike dhe as të zgjatura në kohë. (ii) Po ashtu, kërkuesja nuk parashtron mjaftueshmërisht arsye serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitave përkatëse të Kodit Civil të vitit 1929 dhe nuk citon ndonjë dispozitë kushtetuese konkrete, e cila mund të caktojë derogim nga rregulli i zbatimit të ligjit në kohë. Ndalimi i fuqisë prapavepruese të ligjit, me përjashtim të ligjit penal favorizues, është ritheksuar vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese. (iii) Pretendimi për ekzistencën e kontradiktës midis rregullimeve të KC-së të vitit 1929 dhe rregullimeve të KC-së në fuqi nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues. (iv) I pabazuar është edhe pretendimi se rregullimi i KC-së të vitit 1929 bie ndesh me KEDNJ-në,



pasi pajtueshmëria *ratione temporis*, sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare, mbështetet në parimin se traktatet nuk kanë fuqi prapavepruese. Ky parim sanksionohet edhe në nenin 5 të ligjit nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

10.2 Në lidhje me themelin e çështjes, pretendimet për cenimin e parimit të mosdiskriminimit dhe të trajtimit të barabartë janë të pabazuara, për faktin se njohja nga ligjvënësi në vitin 1929 si trashëgimtarë ligjorë të fëmijëve të lindur nga martesë, ashtu dhe të atyre të lindur jashtë martesë, nuk presupozon mohimin e tagrit ligjor për të përfutuar nga *de cuius*.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

*A. Për kërkesën e palës së paditur në gjykimin e zakonshëm për t'u legjitimuar si subjekt i interesuar*

11. Gjykata në seancën plenare mbi bazë dokumentesh mori në shqyrtim paraprakisht kërkesën e paraqitur nga pala e paditur në gjykimin civil për t'u legjitimuar si subjekt i interesuar në gjykimin kushtetues të kërkesës të paraqitur nga Gjykata e Apelit Durrës për kontroll incidental të normave të Kodit Civil të vitit 1929. Në parashtrimet e paraqitura argumentohet fakti se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës për pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese është bazuar në kërkesën e tyre, dhe se ata kanë interes të drejtpërdrejtë në gjykimin kushtetues, pasi disponojnë argumente të detajuara lidhur me çështjen konkrete. Për më tepër, pjesëmarrja e tyre në gjykimin kushtetues siguron respektimin e parimit të barazisë së armëve, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe 6 të KEDNJ-së.

12. Gjykata, referuar jurisprudencës kushtetuese, rithekson se është në diskrecionin e saj të vendosë mbi kategoritë e subjekteve që thirren si subjekte të interesuara në çështje me interes publik. Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 39, shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, nuk i parashikon subjektet e interesuara në mënyrë shteruese, por përcakton kriterin e “interesit të drejtpërdrejtë” që duhet të ketë subjekti për çështjen që shqyrtohet. Në vlerësimin e interesit të kërkuarit për të vënë në lëvizje Gjykatën dhe të interesit të drejtpërdrejtë të subjektit të

interesuar respektohen kriteret e ndryshme. Në çështjet me interes publik, interesi i drejtpërdrejtë i subjekteve të interesuara duhet kuptuar dhe si interes për të kontribuar në vendimmarrjen e kësaj Gjykate për çështjen që shqyrtohet. Kështu, vlerësimi i legjitimitit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por edhe të gjykimit kushtetues. Gjykata është shprehur se në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato subjekte që, për shkak të veprimtarisë apo rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuarit apo kryesisht nga Gjykata.

13. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata, nisur nga natyra abstrakte e gjykimit kushtetues gjatë kontrollit incidental të normës ligjore, i cili ka për objekt vlerësimin e pajtueshmërisë së normave të kundërshtuara me Kushtetutën, dhe po ashtu bazuar në faktin se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës për pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese ka reflektuar në mënyrë të detajuar pretendimet dhe argumentet e parashtruara nga mbrojtësit e palës së paditur në seancën gjyqësore të datës 3.5.2016, vlerëson se kërkesa për t'u legjitimuar si subjekt i interesuar është e pabazuar dhe si e tillë nuk duhet pranuar.

*B. Për legjitimitimin e gjykatës referuese*

14. Çështja e legjitimitit të subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, që parashikon se “*kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese*”. Ndërsa, sipas nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, gjykata apo gjyqtari, kur çmon se ligji është antikushtetues, është i detyruar të argumentojë para Gjykatës Kushtetuese ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete (*shih vendimet nr. 50, datë 10.7.2015; nr. 22, datë 11.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata në vazhdimësi ka vlerësuar se që të legjitimohet gjykata referuese gjatë një kontrolli incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me



Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: (i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; (ii) të parashtrijë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; (iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; (iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 26, datë 22.5.2015; nr. 22, datë 11.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohet. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 39, datë 30.6.2014; nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 22, datë 11.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kërkesat e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese duhen vlerësuar si kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, çfarë nënkupton se gjykata referuese duhet të evidentojë jo vetëm objektin, por edhe standardin kushtetues të cenuar në funksion të inicimit të gjykimit kushtetues, pra jo vetëm normën ligjore, por edhe parimet apo standardet kushtetuese që ajo cenon në rast se zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i vetëm njërit prej kriterëve kushtetuese që kërkuar të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se normat juridike i nënshtrohen kontrollit kushtetues nëse janë në fuqi në kohën e kontrollit, ose e thënë ndryshe nëse janë akte të vlefshme që prodhojnë pasoja juridike (*shih vendimin nr. 9, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo

kërkesë, sipas Gjykatës, përputhet me frymën e nenit 132 të Kushtetutës, i cili parashikon se Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Në këtë kuptim është e natyrshme që të përjashtohen nga kontrolli kushtetues norma juridike të cilat nuk janë në fuqi ose janë ndryshuar ose shfuqizuar (*shih vendimin nr. 3, datë 5.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, krahas rregullit të përgjithshëm jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se si rast përjashtimor, kontrollit kushtetues i nënshtrohen edhe norma juridike të shfuqizuara kur këto, si pjesë e së drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar (*shih vendimin nr. 2, datë 31.1.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Duke iu rikthyer çështjes konkrete Gjykata konstaton se gjykata referuese ka pretenduar se nenet 469/4, 486/1/2/3 dhe 487 të Kodit Civil të vitit 1929 bien ndesh me nenet 18/1, 41/2 dhe 54/2 të Kushtetutës, me nenin 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Sipas kërkuarës, normat ligjore objekt kundërshtimi nuk janë në fuqi, por gjejnë zbatim në mosmarrëveshjen civile për shkak të parashikimit të nenit 318/2 të KC-së se “trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur”.

19. Gjykata vëren se rregullimet ligjore të Kodit Civil në lidhje me kohën e çeljes së trashëgimisë ligjore dhe efekteve që ato sjellin kanë qenë edhe më herët objekt analize dhe shqyrtimi nga jurisprudenca kushtetuese, e cila është shprehur: “Është parim i njohur dhe i pranuar nga të gjitha legjislacionet se trashëgimia çelët në kohën kur vdes trashëgimlënësi dhe rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur. Ky parim është shprehur edhe në nenin 318 të Kodit tonë të ri Civil. Edhe në dispozitat kalimtare të këtij Kodi, në nenin 1162 thuhet se: “... Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij”. Në lidhje me rregullin e nenit 1162 të Kodit Civil të ri, gjykata e gjen të nevojshme të japë disa sqarime. Sipas një rregulli juridik me karakter të përgjithshëm, çdo ligj i ri nuk vepron veçse për të ardhmen, përveç kur ligjvënësi për një ligj ose një dispozitë të veçantë të tij vendos ndryshe. Përjashtimi nga ky rregullim i përgjithshëm ka një hapësirë zbatimi shumë të kufizuar.



*Ligji i ri nuk mund të zbatohet në faktet e para hyrjes në fuqi të ligjit të ri ose t'u njohë këtyre fakteve efekte të ndryshme nga ato që kishin kur ishte në fuqi ligji i shfuqizuar...”* (shih vendimin nr. 11, datë 21.5.1997 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Në lidhje me rrethin e trashëgimtarëve ligjorë në vendimin e mësipërm Gjykata ka vijuar arsyetimin duke theksuar: “... sikundër u vu në dukje më parë, trashëgimia çelët në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit dhe në mungesë të një testamenti të lënë prej tij, si trashëgimtarë ligjorë thirren në trashëgim personat të cilësuar si i atillë nga ligji në fuqi në kohën e çeljes së trashëgimisë. Këta me çeljen e trashëgimit, sipas radhës së caktuar nga ligji, bëhen “ipso jure” pronarë të pasurisë trashëgimore.”

21. Po ashtu, Gjykata konstaton se lidhur me ligjin e zbatueshëm në kohën e çeljes së trashëgimisë dhe efektet e tij edhe praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë ka një qëndrim të unifikuar të shprehur në vendimin nr. 24, datë 13.3.2002, ku Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë: “Trashëgimia çelët në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, fizikisht të konstatuar ose të përcaktuar me vendimin gjyqësor të shpalljes së vdekjes. Përcaktimi i këtij momenti është i një rëndësie të veçantë praktike, pasi në funksion të tij përcaktohet rrethi i trashëgimtarëve që thirren në trashëgimi, të drejtat e tyre dhe momenti i kalimit të së drejtës së trashëgimisë. Është ky moment ai që përcakton edhe ligjin e aplikueshëm lidhur me efektet që pasojnë çeljen e trashëgimisë. Duke u bazuar në parimin se ligji civil, si rregull, nuk ka fuqi prapavepruese (retroaktive) ... arrijmë në përfundimin se ligji që zbatohet për marrëdhënien e trashëgimisë, është ligji në fuqi në kohën e çeljes së saj”.

22. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata, referuar si praktikës gjyqësore, ashtu edhe legjislationit civil, i cili, megjithëse i ndryshuar në vite, ka mbetur konsekuent lidhur me momentin e çeljes së trashëgimisë dhe ligjin e aplikueshëm, vlerëson se me kohën e çeljes së trashëgimisë lidhen ngushtësisht përcaktimi i vëllimit të së drejtave pasurore dhe detyrimeve që u kalojnë trashëgimtarëve, rrethi i trashëgimtarëve, ecja e afateve që lidhen me marrëdhënien e trashëgimisë, si dhe ligji i zbatueshëm. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se ndryshimi i një parimi të së drejtës trashëgimore, i konsoliduar ndër vite, do të sillte si pasojë krijimin e një gjendjeje pasigurie dhe mungese stabiliteti në marrëdhëniet trashëgimore. Në çështjet trashëgimore respektimi i të drejtave të fituara dhe i parimit të sigurisë juridike marrin

rëndësi thelbësore. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore (shih vendimin nr. 20, datë 15.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata rithekson se ligjvënësi, sipas kushteve ekonomike e sociale në një periudhë të caktuar, ka të drejtën të ndryshojë trashëgimtarët ligjorë (duke zgjeruar ose ngushtuar rrethin e tyre), por norma e re e ligjit të ri zbatohet për të ardhmen, për trashëgimitë e çelura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

23. Për sa u takon pasojave juridike që sjell marrëdhënia e trashëgimisë ligjore, Gjykata vlerëson se ato janë të tilla që nuk lidhen apo kushtëzohen me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se çështja konkrete nuk përbën rast përjashtimor kur normat e shfuqizuara mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues.

24. Po ashtu, Gjykata rithekson se në kuptim të legjitimitetit për inicimin e kontrollit incidental nuk është i mjaftueshëm vetëm identifikimi i lidhjes së drejtpërdrejtë, pra të provuarit se dispozita e kundërshtuar do të zbatohet në çështjen konkrete, por është po aq e rëndësishme që vendimi për pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese të arsyetohet edhe nga pikëpamja e bazueshmërisë së çështjes në lidhje me parametrat kushtetues të referuar si të cenuar nga dispozita e kundërshtuar. Për rrjedhojë, Gjykata e vlerëson të gabuar referimin e kërkuësës në nenet 469/4, 486/1/2/3 dhe 487 të Kodit Civil të vitit 1929, për faktin se këto norma thirren për zbatim në rastin konkret për shkak të nenin 318/2 të Kodit Civil, që indirekt përbën normën ligjore të zbatueshme në çështjen konkrete, pasi është burim i delegimit në normat e Kodit Civil të vitit 1929, si ligji i kohës së çeljes së trashëgimisë në rastin konkret.

25. Për sa më sipër, në vlerësimin e Gjykatës nuk është arritur të argumentohet mjaftueshëm në nivel kushtetues nga gjykata referuese se parashikimi ligjor në nenin 318/2 të KC-së në fuqi, si norma që referon në ligjin e zbatueshëm në kohën e çeljes së trashëgimisë, është i vesuar nga pikëpamja kushtetuese ose se në ç'mënyrë ai bie



ndesh me parimet dhe standardet kushtetuese të pretenduara nga gjykata referuese.

26. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson qëndrimin se është e domosdoshme që gjykata referuese përpara se të pezullojë procesin gjyqësor dhe të kërkojë kontrollin incidental të normës juridike, duhet të verifikojë nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe nëse nuk ka, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën, me qëllim garantimin e dhënies së drejtësisë efektive. Gjykata referuese përpara se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese duhet t'i kishte vlerësuar në mënyrë substanciale arsyet të cilat e kanë shtyrë ligjvënësin që në ndryshimet më të fundit ligjore me ligjin nr. 121/2013 në Kodin Civil aktual të përfshijë dispozita të veçanta në lidhje me kohën dhe vendin e çeljes së trashëgimisë apo dhe ligjin e zbatueshëm. Në kushtet kur gjykata referuese nuk ka arritur të paraqesë argumente bindëse për të mbështetur kërkesën e saj, kjo kërkesë është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet.

27. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata e Apelit Durrës nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134/1/dh dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo

#### VENDIM

Nr. 9, datë 7.2.2017

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 15.11.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 68/8 Akti, që i përket:

KËRKUES: Dritan Zela, Fiqirete Zela, Eliona Lasku (Zela), HASAN ZELA, Kujtim Petrela, Tefik Tershana, Irma Tershana, Sheriban Panariti, Sabina Gjinali, asije Zela, Nexhat Gjinali, Shefki Petrela, Arben Petrela

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Vasil Jovani

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 12846, datë 26.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2200, datë 24.10.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-1861, datë 11.7.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar Vasil Jovani, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



## VËREN:

## I

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë të trashëgimlënësit Mustafa Zela, i cili deri në vitin 1939 ka pasur në pronësi një truall me sipërfaqe 13027m<sup>2</sup>, me vendndodhje dhe kufij të përcaktuar. Me vendimin nr. 60, datë 2.9.1939 të Komisionit për Instalimin e Nëpunësve në Tiranën e Re, ky shtetas është shpronësuar për pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe trualli, duke i mbetur në pronësi parcela me sipërfaqe 821m<sup>2</sup>, për të cilën kërkuesit i janë drejtuar gjykatës me kërkesë për vërtetimin e faktit të pronësisë.

2. Me vendimin nr. 378, datë 16.10.2000, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë ka njohur pronar shtetasin Vasil Jovani për një sipërfaqe prej 459 m<sup>2</sup>.

3. Me vendimin nr. 2462, datë 13.7.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Detyrimin e Bashkësë Tiranë të njohë pronar Mustafa Zelën për sipërfaqen e lirë të truallit prej 830m<sup>2</sup> të ndodhur në Bulevardin Zhan D’Ark.”*

4. Me vendimin nr. 45, datë 29.3.2002, KKKP-ja Tiranë, e vënë në lëvizje nga kërkuesit, është shprehur: *“...meqenëse mbi këtë sipërfaqe nga ana e KKKP-së Tiranë janë dhënë dy vendime, komisioni do të shprehet pasi të zgjidhet në rrugë gjyqësore mbivendosja.”*

5. Kërkuesit i janë drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) për rishikimin e vendimeve nr. 63, datë 25.6.1997 të dhënë në favor të shtetasit Halit Karapici dhe nr. 378, datë 16.10.2000 të dhënë në favor të shtetasit Vasil Jovani.

6. Me vendimin nr. 1286, datë 16.11.2011, AKKP-ja ka vendosur mungesën e juridiksionit për të rishikuar këto vendime, mbështetur edhe në vendimin nr. 43, datë 6.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese me të cilin u shfuqizua dispozita e ligjit që i njihet drejtorit të AKKP-së të drejtën e rishikimit të vendimeve të KKKP-së.

7. Kërkuesit i janë drejtuar gjykatës me padi për shpalljen e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 378, datë 16.10.2000 të KKKP-së, Tiranë. Me vendimin nr. 12846, datë 26.12.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe prova.

8. Me vendimin nr. 2200, datë 24.10.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të gjykatës së shkallës së parë.

9. Me vendimin nr. 00-2014-1861, datë 11.7.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit.

10. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit. Me vendimin nr. 65, datë 30.9.2015, Gjykata Kushtetuese ka vendosur refuzimin e kërkesës, pasi gjatë votimit nuk u arrit shumica e votave të të gjithë anëtarëve të saj për asnjë nga pretendimet e kërkuesve.

11. Në datën 26.7.2016 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat shkaqe.

## II

12. **Kërkuesit Dritan Zela** etj. në mbështetje të kërkesës së tyre parashetrojnë para Gjykatës këto shkaqe:

12.1 Është cenuar e drejta e aksesit, pasi gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë mbajtur qëndrimin se kërkuesit nuk legjitimohen për të ngritur padi në gjykatë derisa pronësia e tyre nuk është njohur me vendim të KKKP-së. Gjykatat ngatërrojnë konceptin e legjitimitetit të palëve dhe të juridiksionit apo të shqyrtimit të çështjes në themel nëpërmjet administrimit të provave. Nëse kërkuesit nuk legjitimohen, atëherë gjykatat nuk kishin arsye për ta shqyrtuar çështjen në themel.

12.2 Nuk është formuar drejt ndërgjyqësia, pasi nuk figurojnë dy trashëgimtarë të palës së paditur. Gjithashtu, nuk është njoftuar rregullisht Avokatura e Shtetit, çka është detyrim ligjor për gjykatën.

12.3 Është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi trupi gjykues në Gjykatën e Apelit nuk është caktuar me short, por me urdhër të kryetarit të gjykatës. Po ashtu, ky parim është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila në kundërshtim me praktikën e zakonshme të saj për shqyrtimin e çështjeve brenda 4-5 vjetësh nga paraqitja e rekursit, e ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesit brenda 9 muajsh.

12.4 Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe ai i arsytimit të





vendimit gjyqësor, pasi në vendimin e Kolegjit Civil nuk janë pasqyruar pretendimet sipas rekursit. Ato janë paraqitur në mënyrë jo të saktë në hyrje të vendimit dhe nuk u është dhënë përgjigje. Po ashtu, pretendimet e parashtruara nga kërkuesit nuk kanë marrë përgjigje nga gjykatat, dhe vendimet e tyre janë kontradiktore.

12.5 Kërkesa e parë është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 3.3.2015, por në përfundim të gjykimit rezultati i votimit ka qenë i tillë që ka çuar në refuzimin e saj. Megjithatë, ligji lejon që kërkesa të përsëritet nëse në të ardhmen sigurohet përbërja e plotë e Gjykatës. Në kushtet kur jemi informuar se aktualisht Gjykata funksionon në përbërje të plotë, sepse është kthyer në detyrë gjyqtarja A.Xh. kemi paraqitur këtë kërkesë me të njëjtën përmbajtje.

13. **Subjekti i interesuar AKKP-ja Tiranë** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

14. **Subjekti i interesuar Vasil Jovani** në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës argumenton sa vijon:

14.1 Kërkuesit nuk legjitimohen *ratione personae*, pasi kërkesa është riparaqitur në datën 26.7.2016, pra jashtë afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga ligji organik i Gjykatës.

14.2 Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit nga Gjykata e Lartë, pasi pretendimet e parashtruara në rekurs duhet të shqyrtoheshin në seancë publike, është i pabazuar. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka në kompetencë të tij të vendosë mospranimin e rekursit kur shkaqet e parashtruara nuk plotësojnë kriteret ligjore. Ky pretendim në thelb lidhet me mënyrën e interpretimit të ligjit dhe nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

14.3 Për pretendimin për mosthirrjen në gjykim të Avokaturës së Shtetit, kërkuesve iu mungon interesi vetjak për ta parashtruar para Gjykatës.

14.4 Pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë është i pabazuar, pasi kërkuesit nuk disponojnë asnjë provë për të bazuar këtë pretendim. Gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme ky pretendim nuk është parashtruar asnjëherë përpara trupit gjykues.

14.5 Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj kërkuesit nuk kanë parashtruar asnjë argument kushtetues.

14.6 Pretendimi për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i

Gjykatës së Lartë është i pabazuar, pasi ky vendim është i arsyetuar, logjik dhe plotëson kriteret ligjore. Jo çdo pretendim i parashtruar nga kërkuesit përbën detyrim për t'u arsyetuar në mënyrë të detajuar nga gjykata.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesve

15. Gjykata vëren se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 8577/2000), (dispozita ligjore në fuqi në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje) ka parashikuar një afat 2-vjeçar për t’iu drejtuar Gjykatës për pretendimet për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Gjykata vëren se vendimi gjyqësor më i fundit në kohë, i kundërshtuar nga kërkuesit, është ai i datës 11.7.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndërsa kërkesa në shqyrtim është paraqitur në Gjykatë në datën 26.7.2016.

16. Po ashtu, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar edhe më parë asaj me kërkesën e datës 16.3.2015 me të njëjtin objekt, e cila, në zbatim të nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000, është refuzuar me vendimin nr. 65, datë 30.9.2015, për arsye se gjatë votimit nuk u arrit shumica e votave për marrjen e një vendimi, e kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i po këtij ligji. Bazuar në nenin 74 të ligjit nr. 8577/2000 kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë ose në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes nuk votohet nga shumica e kërkuar, Gjykata Kushtetuese vendos refuzimin e kërkesës. Po sipas kësaj dispozite refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesi të riparaqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar. Për pasojë, me kërkesën në shqyrtim të datës 26.7.2016, kërkuesit i janë drejtuar sërish Gjykatës, duke pretenduar se aktualisht Gjykata funksionon në përbërje të plotë, sepse është kthyer në detyrë gjyqtarja A.Xh. dhe se ligji lejon që kërkesa të përsëritet nëse në të ardhmen sigurohet përbërja e plotë e Gjykatës.



17. Gjykata ka theksuar se nga parimi kushtetues i shtetit të së drejtës buron e drejta e kujtdo, që pretendon se të drejtat ose liritë e tij janë cenuar, për një gjykim të drejtë përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj; që kjo e drejtë nuk mund të kufizohet artificialisht dhe që zbatimi i saj nuk duhet të pengohet në mënyrë të paarsyeshme; që e drejta e individit kundër veprimeve të paligjshme të individëve të tjerë apo institucioneve shtetërore nuk duhet të mbrohet vetëm formalisht, por dhe realisht e efektivisht. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), si një nga aspektet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen. Këto dispozita sanksionojnë në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses (*shih vendimin nr. 17, datë 19.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë duhet kuptuar si mundësi e çdo individ për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimin nr. 5, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'iu siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve

të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (shih vendimin nr. 45, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Edhe sipas GJEDNJ-së, neni 6 i Konventës nuk i detyron shtetet kontraktuese të krijojnë gjykata apeli apo kasacioni. Megjithatë, një shtet i cili i krijon ato gjykata, duhet të sigurojë që personat subjekt i ligjit të gëzojnë përpara këtyre gjykatave garancitë themelore të përfshira në nenin 6 të Konventës. Këto garanci përfshijnë të drejtën për të pasur një përgjigje përfundimtare në një çështje që i është paraqitur gjykatës që nënkupton një vendim në lidhje me pranueshmërinë dhe/ose meritën e pretendimeve kushtetuese (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Marini kundër Shqipërisë, datë 7.7.2008*).

19. Në lidhje me parashikimin e nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000, GJEDNJ-ja ka theksuar se mosarritja nga ana e Gjykatës Kushtetuese e shumicës së votave për pretendimet e ngritura e lë kërkuesin pa një përgjigje përfundimtare në çështjen e tij dhe për pasojë kufizon thelbin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Vetëm fakti se rrethanat mund të ndryshojnë dhe kërkuesi mund të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij në një moment të ardhshëm, të papërcaktuar në kohë, nuk mund të plotësojë kërkesat e sigurisë juridike. Për më tepër, në rastin e refuzimit të kërkesës nuk jepet asnjë arsyetim përveçse shkakut të mosarritjes së shumicës. Duke pasur parasysh sa më sipër, GJEDNJ-ja ka konkluduar se parashikimet e nenit 74, të ligjit nr. 8577/2000, janë të tilla që e privojnë kërkuesin nga një e drejtë efektive për të pasur një përgjigje përfundimtare për ankimin e tij (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Marini kundër Shqipërisë, datë 7.7.2008*).

20. Sipas GJEDNJ-së (po aty) sistemi shqiptar në rastin e mosarritjes së shumicës është i ndryshëm nga shtetet e tjera. Në ndryshim nga sistemet e tjera ligjore, të cilat ose parandalojnë një situatë të tillë, ose parashikojnë alternativa të ndryshme për të marrë një vendim përfundimtar në një rast të tillë, në sistemin ligjor shqiptar një votim i barabartë në Gjykatën Kushtetuese rezulton në një vendim që formalisht nuk përcakton çështjen e ankimit. Nisur nga sa më sipër, ligjvënësi shqiptar në ndryshimet që i janë bërë ligjit nr. 8577/2000 (të cilat nuk kishin hyrë në fuqi në momentin e shqyrtimit të kësaj



çështjeje) ka shfuqizuar nenin 74 të ligjit, si dhe ka ndryshuar nenin 73 të tij duke parashikuar në pikën 4 të kësaj dispozite se kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

21. Megjithatë, Gjykata vlerëson se e drejta e aksesit nuk është absolute dhe ajo u nënshtrohet kufizimeve veçanërisht kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, duke qenë se nga vetë natyra e saj ka nevojë për rregullime nga ana e shtetit, i cili gëzon një hapësirë vlerësimi në lidhje me këtë (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Marini kundër Shqipërisë, datë 7.7.2008*). Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën qëllim në vetvete, por është në funksion të parimit të sigurisë juridike, si një nga parimet themelore të shtetit të së drejtës (*shih vendimin nr. 17, datë 19.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej apo prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimin nr. 18, datë 31.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577/2000, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastet kur Gjykata është shprehur më parë me vendim për themelin e pretendimeve të ngritura nga palët, në situatën e riparimit të kërkesës ajo ka vlerësuar se vendimi i mëparshëm përbën pengesë në aspektin kushtetues, për sa kohë që është mbajtur një qëndrim përfundimtar lidhur me të njëjtat shkaqe të ngritura sërish në kërkesë (*shih vendimin nr. 60, datë 28.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në dallim nga këto raste, në rastet e vendimit të refuzimit Gjykata nuk ka asnjë pengesë për të marrë sërish në shqyrtim të

gjitha pretendimet e riparimit në kërkesë dhe për t'u dhënë atyre një përgjigje të arsyetuar, për sa kohë që Gjykata nuk ka mundur më parë të arrijë shumicën e kërkuar për pranimin apo rrëzimin e tyre, dhe ky lloj vendimi i saj nuk përbën gjë të gjykuar. Në këtë kuptim, vendimi i refuzimit të kërkesës nuk përbën pengesë që kërkesi të riparuesë kërkesën, sipas nenit 74 të ligjit, por kjo dispozitë nuk mund të interpretohet se kërkesi mund t'i drejtohet pa asnjë kufizim Gjykatës. Sipas nenit 125/6 të Kushtetutës përbërja e saj përtërihet çdo 3 vjet në një të tretën e saj. Hipotetikiqisht, nëse do të pranohet se në rastet e dhënies së një vendimi refuzimi nuk ka asnjë afat kohor për të riparimit kërkesën, kërkesi do të mund t'i drejtohej Gjykatës çdo tre vjet duke vlerësuar se janë krijuar kushte të reja për formimin e një shumice për pranimin apo rrëzimin në themel të kërkesës, për sa kohë që përbërja e cila e ka votuar njëherë çështjen e ka shprehur mendimin e saj. Në vlerësimin e Gjykatës kjo hipotezë është e papranueshme dhe nuk respekton kërkesat për barazinë e individëve në të drejta dhe të sigurisë juridike në rendin ligjor. Duke interpretuar në mënyrë harmonike dispozitat e ligjit nr. 8577/2000 të zbatueshme për zgjidhjen e kësaj çështjeje, Gjykata vlerëson se në të gjitha rastet kur ajo vihet sërish në lëvizje nga palët duhet të verifikojë respektimin e afatit ligjor, i cili si një afat prekluziv nuk mund të anashkalohet nga palët dhe një qëndrim i ndryshëm do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike për palët e tjera që kanë një vendim gjyqësor përfundimtar në favorin e tyre.

23. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se kërkesit nuk kanë pasur asnjë pengesë për t'iu drejtuar asaj me kërkesë me të njëjtin objekt pas dhënies së vendimit të refuzimit deri në përfundimin e afatit ligjor 2-vjeçar. Argumenti se ata i janë drejtuar Gjykatës pasi janë informuar se aktualisht ajo funksionon në përbërje të plotë, për shkak se është kthyer në detyrë gjyqtarja A.Xh., nuk mund të pranohet. Sipas nenit 133/2 të Kushtetutës, Gjykata merr vendim përfundimtar me shumicën e anëtarëve të saj, kurse sipas nenit 32 të ligjit nr. 8577/2000 seanca plenare mund të çelet me praninë e jo më pak se 2/3-ës së gjyqtarëve. Po ashtu, sipas nenit 72/2 të ligjit nr. 8577/2000 vendimet merren me



shumicën e votave të gjyqtarëve, kurse sipas nenit 73/2 të tij në rast se pjesëmarrja e gjyqtarit në votim nuk mund të sigurohet brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vendos kur formohet shumica absolute e anëtarëve të saj. Për rrjedhojë, ligji ka rregulluar edhe rastet kur gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të marrë pjesë në gjykim ose në bisedime dhe në votim. Fakti se në vendimin nr. 65, datë 20.10.2015 për refuzimin e kërkesës kanë marrë pjesë 8 gjyqtarë nuk nënkupton se Gjykata nuk ka funksionuar në përbërje të plotë, por se ka pasur një shkak objektiv për mospjesëmarrjen në atë gjykim të të gjithë anëtarëve të saj.

24. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nuk ka respektuar afatin ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkesit nuk legjitimohen *ratione temporis* për t'ju drejtuar kësaj Gjykate.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Vladimir Kristo

#### MENDIMI PARALEL

Mendoj se qëndrimi i shumicës për rrëzimin e kërkesës për arsye legjitimitimi nuk është në pajtim me nenin 42 të Kushtetutës. Sipas shumicës, kërkesa e paraqitur nuk ka respektuar afatin ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkesit nuk legjitimohen *ratione temporis* për t'ju drejtuar kësaj

Gjykate. Jam kundër këtij konkluzioni për arsyet që vijojnë.

1. Sipas rrethanave rezulton se kërkesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit. Me vendimin nr. 00-2014-1861, datë 11.7.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit. Me vendimin nr. 65, datë 30.9.2015, Gjykata Kushtetuese ka vendosur refuzimin e kërkesës, pasi gjatë votimit nuk u arrit shumica e votave të gjithë anëtarëve të saj për asnjë nga pretendimet e kërkesve. Në datën 26.7.2016 kërkesit i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat shkaqe. Kërkesit i janë drejtuar Gjykatës, duke pretenduar se Gjykata funksionon në përbërje të plotë, me kthimin në detyrë të gjyqtarës A.Xh., dhe se ligji lejon që kërkesa të përsëritet nëse në të ardhmen sigurohet përbërja e plotë e Gjykatës.

2. Sipas shumicës, kërkesit e kanë riparaqitur kërkesën në datën 26.7.2016, jashtë afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga ligji organik i Gjykatës, prandaj dhe kërkesa rrëzohet (*prg.24 i vendimit*).

3. Ashtu sikundër edhe shumica ka elaboruar, në lidhje me parashikimin e nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000, GJEDNJ-ja ka theksuar se mosarritja nga ana e Gjykatës Kushtetuese e shumicës së votave për pretendimet e ngritura e lë kërkesin pa një përgjigje përfundimtare për çështjen e tij dhe për pasojë kufizon thelbin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Vetëm fakti se rrethanat mund të ndryshojnë dhe kërkesi mund të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij në një moment të ardhshëm, të papërcaktuar në kohë, nuk mund të plotësojë kërkesat e sigurisë juridike. Për më tepër asnjë arsyetim nuk jepet në rastin e refuzimit të kërkesës përveçse shkakut të mosarritjes së shumicës. Duke pasur parasysh sa më sipër, GJEDNJ-ja ka konkluduar se parashikimet e nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000 janë të tilla që e privojnë kërkesin nga një e drejtë efektive për të pasur një përgjigje përfundimtare për ankimin e tij (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Marini kundër Shqipërisë, datë 7.7.2008*). Pra, nga analiza e GJEDNJ-së, rezulton se neni 74 i ligjit nr. 8577/2000, nuk ofron standardet e kërkuara kushtetuese që të respektojnë njëkohësisht edhe të drejtën e aksesit edhe parimin e sigurisë të palëve ndërgjyqëse të



përfshira në një gjykim kushtetues. Duke identifikuar këtë problem ligjor, GJEDNJ nuk e përjashtoi Gjykatën Kushtetuese nga përgjegjësia dhe detyrimi për të dhënë drejtësi kushtetuese, e cila e kishte mundësinë që të bënte përpjekjet e duhura për të dhënë vendim, edhe pse neni 74 i ligjit ofronte refuzim kërkesë.

4. Shumica ka vlerësuar, duke interpretuar në mënyrë harmonike dispozitat e ligjit nr. 8577/2000 (të zbatueshme për zgjidhjen e kësaj çështjeje), se në të gjitha rastet kur ajo vihet sërish në lëvizje nga palët duhet të verifikojë respektimin e afatit ligjor, i cili si një afat prekluziv nuk mund të anashkalohet nga palët dhe një qëndrim i ndryshëm do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike për palët e tjera që kanë një vendim gjyqësor përfundimtar në favorin e tyre (*prg.22 i vendimit*). Në këtë rast, shumica duke bërë një interpretim të nenit 74 dhe nenit 30/2 të ligjit, i ka dhënë prioritet afatit ligjor për paraqitjen e kërkesave.

5. Vlerësoj se ky lloj interpretimi i shumicës për afatin prekluziv 2-vjeçar i mohon kërkuuesve të drejtën për akses në gjykatë dhe për rrjedhojë edhe të drejtën efektive për të pasur një përgjigje përfundimtare për kërkesën. Prandaj, me dhënien e vendimit të parë të Gjykatës Kushtetuese për refuzimin e kërkesës, afati dyvjeçar duhej ndërprerë, sipas nenit 131/b të Kodit Civil. Sipas nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000, refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesi ta riparaqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar. Është e vërtetë që kjo dispozitë në rastet e dhënies së një vendimi refuzimi nuk ka asnjë afat kohor për të riparaqitur kërkesën, por në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë ose nuk arrihet shumica e kërkuar ligji bën shtyrjen e çështjes deri në një kohë të papërcaktuar, derisa rrethanat që sollën ndarjen e votave në mënyrë të barabartë apo mosarritjen e shumicës së kërkuar të mos ekzistojnë më (*Marini kundër Shqipërisë, prg.76*). Në një interpretim të zgjeruar në favor të aksesit të individit, zhdukja e shkaqeve, të cilat sollën refuzimin e kërkesës, do të duhej të merrej si datë rifillimi e afatit 2-vjeçar të ndërprerë për ripërsëritjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

6. Mendoj se është përgjegjësi e kësaj Gjykate organizimi dhe funksionimi në atë mënyrë që të arrijë të japë drejtësi kushtetuese, prandaj dhe në

rastin konkret, ku nuk arriti të prodhojë vendimmarrje dhe kërkuuesve nuk iu dha përgjigje për pretendimet e tyre, kjo gjykatë nuk mund t'i penalizojë ata nëpërmjet një interpretimi ligjor të disfavorshëm për ta. Edhe sipas GJEDNJ-së, është theksuar se pikërisht pamundësia e Gjykatës Kushtetuese për të siguruar shumicën e kërkuar të votave për çështjet në shqyrtim, e la ankuesin pa një vendim përfundimtar dhe për rrjedhojë kufizoi thelbin e së drejtës së tij për t'u dëgjuar nga gjykata. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës (*Marini kundër Shqipërisë, prg.122*).

7. Nga ana tjetër, shumica ka shqyrtuar çështjen në seancë plenare, që do të thotë se duhej të merrej me themelin e pretendimeve tashmë dhe jo me *locus standi* të kërkuuesve.

8. Si konkluzion, kërkesa në gjykimin tim duhej të ishte rrëzuar, si e pabazuar në themel<sup>1</sup>, por jo për mungesë legjitimitimi (*ratione temporis*). Duhej të ishte shqyrtuar themeli i pretendimeve, dhe vetëm pas kësaj faze procedurale mund të ishte vendosur për rrëzim kërkesë, duke plotësuar standardin e aksesit në gjykatë dhe dhënien përgjigje pretendimeve të palëve.

Kryetar: Bashkim Dedja

#### MENDIM PAKICE

1. Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetasve Dritan Zela etj. me arsyetimin se kërkesa e paraqitur nuk ka respektuar afatin ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577/2000 dhe, për rrjedhojë, kërkuessit nuk legjitimohen *ratione temporis* për t'iu drejtuar kësaj Gjykate (*shih paragrafin nr. 24 të vendimit të shumicës*). Në këtë drejtim, shumica ka vërejtur se vendimi gjyqësor më i fundit në kohë, i kundërshtuar nga kërkuessit, është ai i datës 11.7.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndërsa kërkesa në shqyrtim është paraqitur në Gjykatë në datën 26.7.2016 (*shih paragrafin nr. 15 të vendimit të shumicës*).

2. Sikurse ka konstatuar edhe shumica, kërkuessit i janë drejtuar edhe më parë asaj me kërkesën e datës 16.3.2015 me të njëjtin objekt, e

<sup>1</sup> Qëndrim i mbajtur edhe me vendimin e parë nr. 65/2015, të Gjykatës Kushtetuese, ku u vendos refuzimi i kërkesës, për shkak të ndarjes së votave në mënyrë të barabartë. (4+4).



cila, në zbatim të nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000, është refuzuar me vendimin nr. 65, datë 30.9.2015 të kësaj Gjykate, për arsye se gjatë votimit nuk u arrit shumica e votave për marrjen e një vendimi, e kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i po këtij ligji. Po sipas nenit 74 të lartpërmendur refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuar të riparqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar. Për pasojë, në datën 26.7.2016 kërkuar i janë drejtuar sërish Gjykatës, duke pretenduar se aktualisht Gjykata funksionon në përbërje të plotë, sepse është kthyer në detyrë gjyqtarja A.Xh. dhe se ligji lejon që kërkesa të përsëritet nëse në të ardhmen sigurohet përbërja e plotë e Gjykatës (*shih paragrafin nr. 16 të vendimit të shumicës*).

3. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se në rastin konkret një trajtim i tillë i ngushtë formalo-juridik i problemit më thelbësor në këtë çështje, interpretimi i nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000, lë jashtë vëmendjes elementin më të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, respektimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, të sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

4. Sikurse konstaton edhe shumica, në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 41, datë 28.9.2011; nr. 21, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'iu siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje

përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 15, datë 17.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Ky qëndrim i Gjykatës është në një linjë me qëndrimet tashmë të konsoliduara të GJEDNJ-së apo gjykatave të tjera simotra. GJEDNJ-ja, që në vitin 1975, në çështjen *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* (çështja 4451/70, vendimi datë 21.2.1975, par. 35), është shprehur se “do të ishte e pakonceptueshme, sipas mendimit të Gjykatës, që neni 6, par. 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve gjatë një procesi dhe të mos mbrojnë në radhë të parë atë që në fakt bën të mundur përfitimin e garancive të tilla, që është aksesit në një gjykatë. Karakteristikat e procedurave gjyqësore, të tilla si: rregullsia, publiciteti dhe shpejtësia nuk do të kenë fare vlerë nëse nuk ka procedura gjyqësore”. Pra, duke bërë një interpretim të të “drejtave efektive”, GJEDNJ-ja në vendimin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* përcaktoi se garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara në detaje nga neni 6 i KEDNJ-së, do të ishin të pavlefshme nëse do të ishte i pamundur fillimi i një procesi gjyqësor<sup>2</sup>.

7. GJEDNJ-ja edhe në çështjen *McElhinney kundër Irlandës* (aplikimi nr. 31253/96, par. 33), si dhe në çështjen *T.P. dhe K.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (aplikimi nr. 28945/95, par. 96) ka

<sup>2</sup> Shih “The European Convention on Human Rights”, Jacobs & White, Oxford, Fourth Edition, f. 170.



ritheksuar se e drejta e aksesit “është një aspekt i pandarë i garancive të mishëruara në nenin 6, duke iu referuar parimeve të shtetit të së drejtës dhe të shmangies së pushtetit arbitrar, që qëndrojnë në themel të Konventës. Kështu, neni 6 § 1 i siguron gjithsecilit të drejtën për të pasur çfarëdo pretendimi në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile përpara një gjykate”.

8. Ndërsa Gjykata Kushtetuese Gjermane është shprehur se “gjykatat nuk mund të injorojnë detyrimin për të respektuar të drejtën e aksesit të individit në gjykatë, përkundrazi ato kanë detyrimin ta respektojnë atë në çdo moment dhe të marrin të gjitha masat që ajo të realizohet **pavarësisht situatës juridike**” (BVerfGE 29, 45).

9. Nga sa më lart, ndryshe nga shumica, jemi të mendimit se në aspektin kushtetues, edhe në këndvështrimin e mjetit efektiv, e drejta e aksesit hyn në të drejtat themelore të individit, të cilat në çdo rast duhet të garantohen nga gjykatat. Çdo mosmarrëveshje apo kundërshti ndërmjet organeve shtetërore dhe individit duhet të ketë si destinacion përfundimtar gjykatat, të cilat duhet t’u japin përgjigje pretendimeve të tyre. Pra, edhe pse si çdo e drejtë tjetër edhe e drejta e aksesit në gjykatë mund t’u nënshtrohet kufizimeve, ato duhet të jenë deri në atë masë sa të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Çka do të thotë se në balancën ndërmjet së drejtës së aksesit dhe mënyrës së interpretimit të ligjit, e drejta e aksesit duhet të mbizotërojë.

10. Në këtë kuptim, sikurse thekson shumica, në lidhje me parashikimin e nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000, GJEDNJ-ja ka theksuar se mosarritja nga ana e Gjykatës Kushtetuese e shumicës së votave për pretendimet e ngritura e lë kërkuesin pa një përgjigje përfundimtare në çështjen e tij dhe për pasojë kufizon thelbin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Vetëm fakti se rrethanat mund të ndryshojnë dhe kërkuesi mund të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij në një moment të ardhshëm, të papërcaktuar në kohë, nuk mund të plotësojë kërkesat e sigurisë juridike. Për më tepër, në rastin e refuzimit të kërkesës nuk jepet asnjë arsyetim përveçse shkakut të mosarritjes së shumicës. Duke pasur parasysh sa më sipër, GJEDNJ-ja ka konkluduar se parashikimet e nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000 janë të tilla që e privojnë kërkuesin nga një e drejtë efektive për të pasur një përgjigje

përfundimtare për ankimin e tij (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Marini kundër Shqipërisë, datë 7.7.2008*).

11. Sipas GJEDNJ-së (*po aty*) sistemi shqiptar në rastin e mosarritjes së shumicës është i ndryshëm nga shtetet e tjera. Në ndryshim nga sistemet e tjera ligjore, të cilat ose parandalojnë një situatë të tillë, ose parashikojnë alternativa të ndryshme për të marrë një vendim përfundimtar në një rast të tillë, në sistemin ligjor shqiptar një votim i barabartë në Gjykatën Kushtetuese rezulton në një vendim që formalisht nuk i jep përgjigje përfundimtare çështjes së ankimit. Nisur nga sa më sipër, ligjvënësi shqiptar në ndryshimet që i janë bërë ligjit nr. 8577/2000 (të cilat nuk kishin hyrë në fuqi në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje) ka shfuqizuar nenin 74 të ligjit, si dhe ka ndryshuar nenin 73 të tij, duke parashikuar në pikën 4 të kësaj dispozite se kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar (*shih paragrafët nr. 19-20 të vendimit të shumicës*).

12. Nga sa më lart, ne gjyqtarët në pakicë jemi të mendimit se Gjykata për defekte të sistemit apo të keqfunksionimit të saj nuk mund të mohojë të drejtën e aksesit të individit. Ky është dhe në vlerësimin tonë kuptimi i nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit, sikurse u përmend më lart, individit mund ta riparaqesë kërkesën e tij kur krijohen kushtet për formimin e shumicës së kërkuar. Këto kushte, për arsye që nuk varen nga vullneti i kërkuesit, mund të bëhen shkak për kalimin e afatit 2-vjeçar të përcaktuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577/2000. Sipas pikëpamjes tonë duke pasur parasysh edhe nenet 131 dhe 134 të Kodit Civil, me paraqitjen e kërkesës së parë para kësaj Gjykate afati ndërpritet dhe koha e kaluar para se të vërtetohej shkakun ndërprerës nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së këtij shkakut fillon një afat parashkrimi i ri.

13. Si përfundim, vlerësojmë se shumica në arsyetimin e saj duhet të bënte një interpretim pajtues të nenit 74 të ligjit nr. 8577/2000 me standardet kushtetuese (të drejtën e aksesit në rastin konkret). Për rrjedhojë, jemi të mendimit se shumica me vendimin e saj, duke rrëzuar kërkesën në fjalë, u ka cenuar kërkuesve të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Anëtarë: Vitore Tusha, Vladimir Kristo



**VENDIM**  
**Nr. 10, datë 13.2.2017**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.12.2016, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 73/12 Akti që i përket:

**KËRKUESE:** Shoqëria “Vodafone Albania” sh.a.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Bashkia Bulqizë, Ministria E Mjedisit

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 259, datë 5.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. 849, datë 11.4.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2015-468, datë 26.2.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 259, datë 5.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 134/1/h të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 45 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, që kërkoi pranimin e kërkesës, pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Mjedisit, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**  
**I**

1. Kërkuesja është person juridik, shoqëri aksionare, i regjistruar në datën 15.5.2001. Bazuar në kontratën e qirasë nr. 7607rep., nr. 1189kol., datë 3.12.2004, lidhur me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Bulqizë, ajo ka marrë me qira një tokë me sipërfaqe 0.03 ha në ekonominë pyjore Shesh Bulqizë (parcela 98/b). Sipas nenit 5.2 të kontratës së qerasë, subjekti i interesuar, në cilësinë e qiradhënësit, i ka njohur kërkuases të drejtën të bëjë ndërtime ose ndryshime në atë pasuri vetëm për qëllime të kësaj kontrate.

2. Në vitin 2004 kërkuuesja është pajisur nga Këshilli i Rregullimit të Territorit i Qarkut Dibër (KRRIT) me lejen e ndërtimit nr. 06, mbi bazën e së cilës ka ndërtuar një nënstacion antene celulare sipas kushteve tekniko-urbane të lejes dhe sheshit të ndërtimit. Leja e ndërtimit u vu në zbatim nga shoqëria “Diekat ndërtim dhe konstruksion” sh.a.

3. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Bulqizë, në vitin 2007 ka konstatuar se kërkuuesja ka kryer kundërvajtjen administrative “Përdorim i paligjshëm i fondit pyjor dhe i tokës pyjore” dhe bazuar në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar ka vendosur një gjobë në masën 100.000 lekë të rinj, si dhe ka përcaktuar dëmin në shumën 15.618.170 lekë. Në këto kushte, subjekti i interesuar i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me kërkesëpadi me objekt: “*Detyrimin e së paditurës të shpërblejë dëmin e shkaktuar në fondin pyjor*”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 275, datë 24.12.2008, ka vendosur pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë, duke vendosur detyrimin e shoqërisë “Vodafone” sh.a. në shumën 240 000 lekë.

4. Kundër vendimit të mësipërm kërkuuesja ka paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 604, datë 31.3.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 275, datë 24.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me trup tjetër gjykes.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, pas rigjyimit të çështjes, me vendimin nr. 259, datë 5.5.2011, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit.





6. Gjykata e Apelit Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkueses, me vendimin nr. 849, datë 11.4.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 259, datë 5.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

7. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit rekursin e kërkueses, me vendimin nr. 00-2015-468, datë 26.02.2015, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmban asnjë prej shkaqeve të përcaktuara në nenin 472 të KPC-së.

## II

8. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 10.6.2016, duke pretenduar se vendimet e gjykatave të zakonshme nuk kanë respektuar standardet e procesit e rregullt ligjor. Në mënyrë të përmbledhur kërkuesja parashtron si vijon:

8.1 Pezullimi i ekzekutimit të vendimi nr. 259, datë 5.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër do të sigurojë për palët ndërgjyqëse krahas një procesi të rregullt, të drejtë e të paanshëm, edhe mënjanimin e dëmit financiar të konsiderueshëm për kërkuesen. Marrja e masës së pezullimit në kushtet e cenimit të dukshëm të standardeve të procesit të rregullt ligjor është emergjente, pasi në të kundërt për kërkuesen do të humbiste kuptimi dhe interesi për mbrojtjen e ligjshmërisë nëpërmjet investimit të gjykatës.

8.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka kryer shkelje të rënda procedurale, pasi nuk ka respektuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 604, datë 31.3.2010 për hetimin e mëtejshëm të ligjshmërisë së ndërtimeve, rikryerjen e aktit të ekspertimit për të vlerësuar nëse ndërtimet ishin kryer brenda kushteve të lejes së ndërtimit, rregullimin e ndërgjyqësisë duke thirrur si person të tretë KRRT-në e Qarkut Dibër, si dhe marrjen e provave nga persona të tretë për të vërtetuar pretendimet e palëve për kryerjen me leje ose jo të ndërtimeve.

8.3 Gjykata ka vendosur kryesisht të riçelë hetimin gjyqësor pas përfundimit të tij, duke urdhëruar veprime procedurale, si caktimi i ekspertit të vlerësimit pyjor dhe kryerja e aktit të ekspertimit. Gjatë rigjykimit të çështjes u pa se personi i caktuar si ekspert ishte në kushtet e papajtueshmërisë, pasi ishte punonjës i subjektit

të interesuar, në pozicionin e shefit të menaxhimit, referuar shkresës nr. 1737, datë 31.03.2011 lëshuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave. Për më tepër, eksperti jo vetëm ka përcaktuar dëmin duke u bazuar në procesverbalet e mbajtura nga subjekti i interesuar, por është bazuar edhe në përmbajtjen e aktit të mëparshëm të ekspertimit, i deklaruar i pavlefshëm nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. 604, datë 31.3.2010.

8.4 Është cenuar *e drejta e aksesit dhe e ankimit*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë gjatë gjykimit të çështjes nuk ka pasqyruar pretendimet për mospërmbushjen e detyrave të lëna pas kthimit të çështjes për rigjykim dhe as i ka analizuar ato. Këto të drejta nuk janë respektuar as gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

8.5 Gjykatat nuk kanë respektuar *standardin kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor*. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër jo vetëm nuk pasqyron detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë, por gjithashtu nuk i analizon ato, duke arritur në përfundim alogjik. Vendimi i Gjykatës së Apelit nuk analizon pretendimin për papajtueshmërinë në ushtrimin e detyrës si ekspert vlerësues të M.H., i cili punonte si shef menaxhimi pranë subjektit të interesuar. Nga ana tjetër, Kolegji Civil nuk ka analizuar pretendimin për moszbatimin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër të detyrave të lëna nga një gjykatë më e lartë. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë nuk ka kontrolluar zbatimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor.

8.6 Gjykatat janë bazuar në një akt ekspertimi i cili pasqyron përmbajtjen e një akti tjetër të konstatuar më parë si i pavlefshëm nga Gjykata e Apelit. Matjet gjeometrike të të dyja ndërtimeve dhe të rrugës lidhëse duhet të kryheshin nga një ekspert topograf pas betimit përpara gjykatës. Përkundrazi, gjykatat, në kundërshtim me nenet 467/e dhe 472/c të KPC-së, pranuan aktin e mëparshëm topografik të vitit 2008 pa i kërkuar ekspertit të bëjë betimin.

8.7 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, pasi moszbatimimi nga Gjykata e Apelit Tiranë i detyrave të lëna nga një kolegji tjetër i së njëjtës gjykatë ka cenuar pritshmëritë e ligjshme si për gjykatën, ashtu edhe për palët ndërgjyqëse.

9. **Subjekti i interesuar, Ministria e Mjedisit**, ka prapësuar me shkrim si vijon:



9.1 Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër është i drejtë dhe në mbështetje të plotë të ligjit dhe të detyrave të përcaktuara nga Gjykata e Apelit në vendimin nr. 604, datë 31.3.2010. Në këtë kuptim nuk ekziston asnjë shkak ligjor dhe procedural për shfuqizimin e vendimit gjyqësor si të papajtuësëm me Kushtetutën.

9.2 Po ashtu i pabazuar është edhe pretendimi në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit, pasi kjo e fundit ka dhënë një vendim të arsyetuar e të bazuar në ligj, prova e fakte.

9.3 Edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është pasqyrim i respektimit të standardeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, përfshi edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

10. **Subjekti i interesuar, Bashkia Bulqizë**, edhe pse është njoftuar rregullisht, nuk ka paraqitur komente me shkrim brenda afatit ligjor.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësës

11. Kërkuësja, shoqëria “Vodafone Albania” sh.a., është person juridik dhe si i tillë, bazuar në jurisprudencën kushtetuese, mund të jetë subjekt i të drejtave dhe lirive kushtetuese në nivel të kufizuar “*për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve*”, në kuptim të nenit 16/2 të Kushtetutës. Disa nga këto liri dhe të drejta nuk është e mundur t’i atribuohen një personi juridik, për shkak të thelbit të tyre ose qëllimit për të cilin ligji i ka dhënë jetë personit juridik. Për sa u përket të drejtave të tjera, personi juridik mund të jetë subjekt i tyre në atë masë dhe në atë kuptim që ato lehtësojnë gëzimin e plotë të këtyre të drejtave dhe lirive për individët (*shih vendimin nr. 19, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për të vlerësuar legjitimitimin e personave juridikë, Gjykata bazohet në të njëjtat elemente që merren në konsideratë për legjitimitimin e individëve, në referim të neneve 131/f, 134/1/i dhe 134/2 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, kërkuësja, shoqëria “Vodafone Albania” sh.a., mund të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues për çështje që lidhen me interesat e saj, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë

shteruar të gjitha mjetet juridike. Kërkesat për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes, rregull ky i parashikuar nga dispozitat tranzitore të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

13. Në vështrim të standardeve të mësipërme dhe bazuar në rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se kërkuësja i përmbush kriteret për legjitimitimin *ratione personae*, pasi pretendimet e saj përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134 të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata Kushtetuese ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues. Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimin nr. 2, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuësja, shoqëria “Vodafone Albania” sh.a., nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat e zakonshme. Për këtë arsye ajo legjitimohet t’i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuësës, *prima facie*, bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të



standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. *Për zëvendësimin procedural të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Bulqizë dhe thirrjen në gjykim si subjekte të interesuara të Bashkisë Bulqizë dhe të Ministrisë së Mjedisit*

16. Gjykata, referuar argumenteve të parashtruara nga kërkuesja, konstaton paraprakisht se bazuar në urdhrin nr. 53, datë 13.2.2014 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së drejtorive të shërbimit pyjor” personaliteti juridik i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Bulqizë i ka kaluar fillimisht Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Dibër dhe më pas Bashkisë Bulqizë, sipas urdhrin nr. 10, datë 20.1.2016 “Mbi procedurën e dyllosjes së zyrave të ish-drejtorive të shërbimit pyjor”. Po ashtu, Gjykata vëren se Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, ka vendosur transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit.

17. Bazuar në rrethanat e çështjes, si dhe referuar nenit 1/2 të ligjit nr. 8755, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 199/2 të Kodit të Procedurës Civile, me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt me ndërgjyqësi të përcaktuara qartë, Gjykata vlerësoi të nevojshëm kalimin procedural dhe marrjen pjesë në cilësinë e subjektit të interesuar të Bashkisë Bulqizë në vend të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Bulqizë.

18. Gjithashtu, Gjykata nisur nga fakti se Ministria e Mjedisit disponon një urdher për vënien në ekzekutim të vendimit nr. 259, datë 5.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, lëshuar me vendimin nr. 58, datë 21.4.2016 të Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Dibër, kryesisht ka çmuar të nevojshëm legjitimitimin si subjekt të interesuar edhe të Ministrisë së Mjedisit, duke vlerësuar se ajo për shkak të veprimtarisë apo rrethanave mund të kontribuojë në shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi.

19. Në këto kushte, Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 12.11.2016 ka vendosur thirrjen në gjykim të Bashkisë Bulqizë dhe të Ministrisë së Mjedisit në cilësinë e subjekteve të interesuara, nisur nga interesi i drejtpërdrejtë i tyre në këtë gjykim.

C. *Për kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër*

20. Kërkuesja ka paraqitur në datën 21.11.2016 kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimi nr. 259, datë 5.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, duke argumentuar se kjo masë është emergjente në kushtet e cenimit të dukshëm të standardeve të procesit të rregullt ligjor, dhe po ashtu të mënjanimin të dëmit financiar të konsiderueshëm ndaj saj.

21. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 13.12.2016 mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 259, datë 5.5.2011 të paraqitur nga kërkuesja dhe vlerësoi se kjo kërkesë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, ajo vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar.

Ç. *Për themelin e pretendimeve*

Ç.1 *Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë*

22. Kërkuesja ka pretenduar se gjatë rigjykimit të çështjes Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka caktuar si ekspert shefin e menaxhimit të subjektit të interesuar, kjo referuar shkresës nr. 1737, datë 31.3.2011 lëshuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.

23. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të



provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues që nuk jep garancitë e nevojshme për një gjykim të paanshëm në këndvështrimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimin nr. 54, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata, referuar nenit 224/c të Kodit të Procedurës Civile (KPC), konstaton se përjashtimi i ekspertit nga pjesëmarrja e tij në gjykim bëhet kur janë kushtet e përcaktuara nga neni 72 i KPC-së, i cili rregullon rastet e përjashtimit të gjyqtarit. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit Tiranë në lidhje me pretendimin e kërkuarit për zhvillimin e procesit gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër në favor të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Dibër, duke caktuar si ekspert një punonjës të saj, ka arsyetuar se “... *eksperti ka zbatuar në mënyrë korrekte nenin 224/b e vijues të KPC-së. Llogaritjet e bëra nga eksperti bazohen plotësisht në aktet ligjore e nënligjore*”.

27. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuari nuk ka argumentuar se në ç’mënyrë shkaqet e pretenduara të papajtueshmërisë së ekspertit kanë ndikuar në

anshmërinë e gjykatës, si në aspektin subjektiv, ashtu dhe në atë objektiv. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar

*Ç.2 Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe të ankimit efektiv*

28. Kërkuarja ka pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë gjatë gjykimit të çështjes nuk ka pasqyruar pretendimet për mospërmbushjen e detyrave të lëna pas kthimit të çështjes për rigjykim dhe as i ka analizuar ato. Sipas kërkuarjes, këto të drejta nuk janë respektuar as gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, gjë që ka sjellë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

29. Neni 43 i Kushtetutës parashikon se “*kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*”. Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit, si pjesë të pandara dhe garanci të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të kësaj Gjykate, e drejta e ankimit duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit është një e drejtë procedurale, që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se “*...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit*”. Në këtë kuptim, në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit, ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë para së gjithash në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njih sistemi i normave procedurale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë. Aksesit në gjykatë është një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe



për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 14, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata, duke e vlerësuar pretendimin e kërkuës në vështrim të sa më sipër, çmon se ai ka të bëjë me çështje të interpretimit të ligjit dhe të zbatimit të tij në çështjet konkrete, si dhe me vlerësimin e fakteve dhe të rrethanave dhe si i tillë i takon juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për sa kohë kërkuësja ka ushtruar ankim dhe rekurs, që përbëjnë mjetet procedurale në dispozicion (formalisht dhe në substancë), Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e aksesit dhe të ankimit efektiv është i pabazuar.

*Ç.3 Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*

32. Sipas kërkuës, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër nuk ka pasqyruar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe nuk i ka analizuar ato, duke arritur në përfundim alogjik. Ndërkohë, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk ka analizuar pretendimin për papajtueshmërinë në ushtrimin e detyrës si ekspert vlerësues të M.H., i cili punonte si shef menaxhimi pranë subjektit të interesuar. Nga ana tjetër, Kolegji Civil nuk ka analizuar pretendimin për moszbatimin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër të detyrave të lëna nga një gjykatë më e lartë, duke mos kontrolluar zbatimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor.

33. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe nga neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme

detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një



vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në vështrim të sa më sipër Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarës për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga gjykatat e dy shkallëve të para është i pabazuar, pasi vendimet objekt kundërshtimi i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese.

38. Për sa i takon pretendimit të kërkuarës për mosrespektimin e standardit të arsyetimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, sipas jurisprudencës kushtetuese arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përdoritur shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 17, datë 17.5.2011; nr. 108, datë 3.10.2012; nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 49 datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në rastin konkret Gjykata vëren se vendimi i mospranimit të rekursit përmban në pjesën hyrëse të tij objektin e padisë, disponimet e gjykatave, si dhe shkaqet që kërkuarës ka parashtruar në recurs. Ndërsa në pjesën arsyetuese, në përputhje me standardet e gjykimit paraprak në dhomën e këshillimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, pasi nuk përmban asnjërin prej rasteve që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, duke vendosur në pjesën urdhëruese mospranimin e tij.

40. Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se pretendimi i kërkuarës për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

*Ç.4 Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike*

41. Sipas kërkuarës moszbatimi nga Gjykata e Apelit Tiranë i detyrave të lëna nga një kolegj tjetër i së njëjtës gjykatë ka cenuar pritshmëritë e ligjshme si për gjykatën, ashtu edhe për palët ndërgjyqëse.

42. Jurisprudenca kushtetuese konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve të shteti i referon te parimi i shtetit të së drejtës. Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përdoritur diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 20, datë 29.9.2008; nr. 38, datë 15.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 23, datë 8.6.2007; nr. 7, datë 10.2.2014; nr. 12, datë 17.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka nënvizuar se parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i gjykimit të drejtë, që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim (*shih vendimin nr. 77, datë 22.12.2015 Gjykatës Kushtetuese*).

44. Në vështrim të rrethanave të çështjes dhe standardit të mësipërm, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk është ngritur në nivel kushtetues.



45. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/h të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,<sup>3</sup>

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo

#### VENDIM

**Nr. 11, datë 13.2.2017**

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.1.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare,

<sup>3</sup> Gjyqtari V. Kristo votoi për pranimin pjesërisht të kërkesës me arsyetimin se është detyrë e Gjykatës së Lartë që në përmbushje të standardit të arsyetimit të vendimit në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe kontrolluese e garantimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta t'i japë përgjigje pretendimit të kërkuësës lidhur me parregullsitë e procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 79/17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Altin Vrioni

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “Ndërtim Montim Patos” sh.a., Shoqëria “Rubin Petrol Patos” sh.a., Saimir Vrioni, Grabon Vrioni, Servete Tirana (Vrioni), Hedije Hoxha (Vrioni), Zija Vrioni, Arshi Vrioni.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-3261 (470), datë 18.9.2014 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 6, 17, 41, 42, 124, 131/f, 134/1/i, 141/1, 142/1 dhe 145/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësës, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, shoqërisë “Ndërtim Montimi Patos” sh.a., që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

#### I

1. Me vendimin nr. 2, datë 19.12.1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) pranë Këshillit të Rrethit Fier, ndër të tjera, ka vendosur: “1. Të njohë pronësinë e ish-pronarit, të ndërimit Kabreman Vrioni, mbi një sipërfaqe toke bujqësore prej 231 ha, e ndodhur në fshatin Grizë-Godolesb, Bashkia Patos, me kufizime: V - me rrugë, L - me rrugë, J - me rrugë dhe P - me tokë bujqësore. 2. Trashëgimtarët ligjorë: 1) Servete Tirana, 2) Hedije Hoxha, 3) Demir Vrioni, 4) Zija Vrioni dhe 5) Arshi Vrioni, të cilët gëzojnë në pjesë të barabarta nga 1/5, të marrin pjesë në aksione në ndërmarrjen e Ndërtim Montimit Patos dhe Krugë Bazamenteve Patos, si pronarë të tokës me vlerën e saj. Për ndërmarrjen e Ndërtim Montimit Patos 30.980 m<sup>2</sup> dhe ndërmarrjen e Krugë Bazamenteve Patos 18.221 m<sup>2</sup>”. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë nga shoqëria “Ndërtim Montim Patos” sh.a. dhe “Rubin Petrol Patos” sh.a.



2. Me vendimin nr. 1522, datë 21.12.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur: *“Pranimin e padisë së palës paditëse “Ndërtim Montim Patos” sh.a. dhe “Rubin Petrol Patos” sh.a., ndaj palës së paditur, KKKP-së pranë Prefekturës së Qarkut Fier, Servete Tirana, Arshi Vrioni, Hedije Hoxha, Altin Vrioni, Zija Vrioni, Sonja Vrioni, Grabon Vrioni e Saimir Vrioni, duke kundërshtuar pikën 2 të vendimit nr. 2, datë 19.12.1995 të KKKP-së pranë ish-Kësbillit të Rrethit Fier. Lënien në fuqi të pikave të tjera të vendimit të mësipërm të KKKP-së”*. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 10.5.2002.

3. Në datën 7.1.2008, pala e paditur në procesin civil, Altin Vrioni, Saimir Vrioni, Grabon Vrioni, Servete Tirana (Vrioni), Hedije Hoxha (Vrioni), Zija Vrioni e Arshi Vrioni, i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit civil nr. 1522, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

4. Me vendimin nr. 00-2012-1815 (292), datë 31.5.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 1522, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjyqësor.”*

5. Subjektet e interesuara, shoqëria “Ndërtim Montim Patos” sh.a. dhe “Rubin Petrol Patos” sh.a., i janë drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

6. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 18, datë 23.4.2013, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-1815 (292), datë 31.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me arsyetimin se shoqëria “Rubin Petrol Patos” sh.a. nuk kishte marrë dijeni për procesin e zhvilluar në Gjykatë të Lartë.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 470, datë 18.9.2014, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 1522, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

## II

8. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë, pasi i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

Faqe | 1960

8.1 Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ka marrë prerogativat që u takojnë gjykatave së shkallës së parë.

8.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, sepse Gjykata e Lartë ka marrë një vendim diametralisht të kundërt me vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë lidhur me të drejtën e rishikimit.

8.3 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë, sepse i ka mohuar kërkuetit të drejtën që të dëgjohet nga gjykata e shkallës së parë.

8.4 Gjykata e Lartë nuk ka respektuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, sepse vendimi i saj është kontradiktor.

9. **Subjekti i interesuar, shoqëria “Ndërtim Montim Patos” sh.a.**, ka prapësuar me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

9.1 Gjykata e Lartë në respekt të kriterëve ligjore të përcaktuara nga KPC-ja, të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe të jurisprudencës kushtetuese ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet kumulative të parashikuara nga neni 494/a i KPC-së. Gjykata e Lartë nuk ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ky vlerësim hyn në diskrecionin e saj.

9.2 Nuk është cenuar parimi i sigurisë juridike, sepse është në kompetencë të Gjykatës së Lartë të vlerësojë nëse prova e paraqitur plotëson kriteret për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

9.3 Sipas jurisprudencës kushtetuese kërkuetit nuk i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi ai i është drejtuar gjykatës, si dhe ka marrë përgjigje për pretendimet e tij.

9.4 Vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për rishikim i ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

#### A. Për legjitimitimin e kërkuetit

10. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f





dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

11. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesi, *prima facie*, legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

*B. Për themelin e pretendimeve të ngritura në kërkesë*

12. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ka marrë prerogativat që i takojnë gjykatës së shkallës së parë. Sipas kërkuetit, Gjykata e Lartë ka shkuar tej kompetencave të saj të parashikuara nga neni 494 i KPC-së kur ka shqyrtuar vlefshmërinë dhe rëndësinë e provave lidhur me themelin e çështjes objekt konflikti. Po ashtu, sipas kërkuetit, është cenuar parimi i sigurisë juridike, sepse Gjykata e Lartë ka marrë një vendim diametralisht të kundërt me vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë lidhur me të drejtën e rishikimit, e drejta e aksesit në gjykatë, sepse Gjykata e Lartë i ka mohuar atij të drejtën të dëgjohet nga gjykata e shkallës së parë, si dhe nuk është respektuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, sepse vendimi i saj është kontradiktor.

13. Subjekti i interesuar, shoqëria “Ndërtim Montim Patos” sh.a., ka prapësuar se Gjykata e Lartë, në respekt të kriterëve ligjore të përcaktuara nga KPC-ja, duke u bazuar në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe në jurisprudencën kushtetuese, ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet kumulative të parashikuara nga neni 494/a i KPC-së. Gjykata e Lartë nuk ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ky vlerësim hyn në diskrecionin e saj. Gjithashtu, subjekti i interesuar, shoqëria “Ndërtim Montim Patos” sh.a., ka prapësuar se nuk është cenuar parimi i sigurisë juridike, sepse është në kompetencë të Gjykatës së Lartë të vlerësojë nëse prova e paraqitur plotëson kriteret për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë; sipas jurisprudencës kushtetuese

kërkuetit nuk i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi ai i është drejtuar gjykatës, si dhe ka marrë përgjigje për pretendimet e tij; vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për rishikim i ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

14. Sipas nenit 72/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Me ndryshimet që iu bënë këtij ligji me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, në nenin 73 është shtuar pika 4 sipas së cilës kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

15. Gjykata vëren, pas shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, se asnjë nga argumentet e paraqitura nga kërkuesi nuk arriti të merrte shumicën e votave të gjyqtarëve të kërkuar nga ligji. Për rrjedhojë, nisur nga sa më lart, kërkesa konsiderohet e rrëzuar<sup>4</sup>.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 73/4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

<sup>4</sup> Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët: Vladimir Kristo, Vitore Tusha dhe Fatmir Hoxha. Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Gani Dizdari, Besnik Imeraj dhe Fatos Lulo.



**VENDIM**  
**Nr. 12, datë 15.2.2017**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 15.12.2016 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 77/15 Akti që i përket:

**KËRKUES:** Afrim Tarelli (Zeneli), përfaqësuar nga avokat Ardian Visha, me prokurë të posaçme

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2016-1269, datë 14.7.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

Pezullimi i ekstradimit të shtetasit Afrim Tarelli deri në një vendimmarrje të drejtë dhe përfundimtare të çështjes.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 29, 34, 131/f dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Konventa Europiane e Ekstradimit; Kodi i Procedurës Penale; neni 42 i ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë në fushën penale”; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të mbrojtësit të kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

Faqe | 1962

**VËREN:**  
**I**

1. Kërkuarisi është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane të drejtësisë, pasi me vendimin nr. 1355/2010, datë 12.4.2010 të Gjykatës së Apelit Torino është dënuar me 6 vjet e 10 muaj burgim për kryerjen e veprës penale “Pjesëmarrje në organizatat kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike”. Kërkuarisi është arrestuar në datën 27.3.2015 nga oficerët e Policisë Gjyqësore të Qarkut Elbasan.

2. Kërkesa për ekstradimin e kërkuarit është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka vendosur lejimin e ekstradimit. Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur kthimin për rigjykim të çështjes. Ndërkohë që zhvillohej procesi i mësipërm, autoritetet italiane kanë dërguar një kërkesë tjetër për lejimin e ekstradimit të shtetasit Afrim Zeneli alias Tarelli nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Italisë, për ekzekutimin e urdhrin të masës së sigurisë “arrest me burg” për kryerjen e veprës penale “Trafikim i lëndëve narkotike”, dhënë me vendimin nr. 3957/12 R.B.G.I.P., datë 24.4.2012 të Gjykatës të Hetimeve Paraprake të Gjykatës së Bolonjës, Itali.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në rigjykimin e çështjes me objekt shqyrtimin e të dyja kërkesave për lejimin e ekstradimit të kërkuarit drejt Italisë, me vendimin nr. 949, datë 21.7.2015, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan duke lejuar ekstradimin e shtetasit Afrim Zeneli alias Tarelli nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Italisë me qëllim ekzekutimin e vendimit nr. 1355/2010 –R.N.G 6404/2009-R.G.N.R., nr. 1028/2006, datë 12.04.2010 (vendim i formës së prerë), dhënë nga Gjykata e Apelit Torino, Itali sipas të cilit shtetasi shqiptar Afrim Zeneli alias Tarelli është dënuar me 6 (gjashtë) vjet dhe 10 (dhjetë) muaj burgim. Refuzimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan sa i përket kërkesës për lejimin e ekstradimit të shtetasit Afrim Zeneli alias Tarelli nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Italisë, në lidhje me ekzekutimin e urdhrin të masës së sigurisë “arrest me burg”, dhënë me vendimin nr. 3957/12 R.B.G.I.P., datë 24.4.2012 të Gjykatës të Hetimeve Paraprake të Gjykatës së Bolonjës, Itali.”.



Gjykata e ka bazuar vendimin e saj për refuzimin e kërkesës së dytë në argumentin se mungonin garancitë për respektimin e së drejtës së mbrojtjes për shkak të procedimit të tij në mungesë.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 23, datë 16.2.2016, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan duke urdhëruar lejimin e ekstradimit në lidhje me kërkesat e prokurorisë.

5. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2016-1269, datë 14.07.2016, marrë në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

## II

6. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 1.9.2016 me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe pezullimin e masës së ekstradimit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

6.1 Procesi i ekstradimit përbën shkelje të parimeve kushtetuese që lidhen me zbatimin e ligjit penal favorizues. Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë ekzistojnë dy marrëveshje në fushën penale të ratifikuara respektivisht në vitin 2004 dhe 2008 nga Kuvendi i Shqipërisë, të cilat mundësojnë veprimin e ligjit penal ndaj një shtetasi të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë.

6.2 Përcaktimi i nenit 29 të Kushtetutës se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese, bën që marrëveshja për ekstradimin të konkurrojë me marrëveshjen dypalëshe me Italinë për njohjen e vendimeve penale të huaja mes dy vendeve dhe ekzekutimin përkatës në vendin e origjinës. Konkurrimi mes këtyre dy akteve, bazuar në nenin 29/3, të Kushtetutës prodhon nevojën e përcaktimit se cili prej tyre është favorizues dhe në rastin konkret marrëveshja e cila mund të veprojë në dëm të kërkuesit është ajo e njohjes së vendimit penal, nëse ekzistojnë kushtet procedurale të nenit 514 të Kodit të Procedurës Penale.

6.3 Bashkimi i gjykimit të dy kërkesave të paraqitura nga pala italiane, përveçse përbën shkelje ligjore të karakterit procedural, bie ndesh edhe me parimin e specialitetit. Neni 14 i

Konventës Europiane të Ekstradimit, rregullim i cili gjendet edhe në nenin 501 të KPP-së dhe në nenin 42 të ligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë”, disiplinon paraqitjen e njëkohshme të detyruar të akteve dhe çështjeve për të cilat kërkohet ekstradimi ose në të kundërt garancinë që shtetasi nuk do t’i nënshtrohet ndëshkimit për vepra të kryera para ekstradimit, për të cilat nuk ishte kërkuar në kohë transferimi ekstradues.

6.4 Ekstradimi është kërkuar në datën 25.3.2014 për ekzekutimin e vendimit nr. 1355, datë 12.4.2010 (i formës së prerë prej datës 14.4.2011) të Gjykatës së Apelit Torino dhe pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për lejimin e ekstradimit është paraqitur kërkesa e dytë e palës italiane sërish për ekstradim, bazuar në një urdhër arresti të lëshuar nga Gjykata e Bolonjës. Kjo kërkesë e palës italiane nuk përbën shtesë të kërkesës së parë, por një kërkesë të re ekstradimi dhe zgjerim të saj në aspektin procedural. Kjo e fundit kërkon dhënien e pëlqimit të subjektit të ekstraduar, procedurë e cila nuk është ndjekur në rastin e kërkuesit.

7. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, ka prapësuar me shkrim si vijon:

7.1 Në referim të parashikimit kushtetues të nenit 29 dhe atij ligjor të nenit 3 të Kodit Penal, parimi i ligjit penal favorizues nënkupton mënyrën se si do të zbatohet ligji, cilësimin e veprave penale të kryera nga i pandehuri, si dhe dënimin që do të caktohet për të në rastin kur ka ndryshime midis ligjit të kohës kur ka ndodhur vepra penale me ligjin e kohës kur i pandehuri po gjykohet. Në rastin konkret, edhe pse nuk ka pasur marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe për ekstradim midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në kohën kur është gjykuar kërkuesi, referuar nenit 11 të KP-së apo nenit 29 të Kushtetutës, ato nuk kanë ndryshuar, ndaj nuk mund të bëhet fjalë për ligj penal favorizues. Për më tepër, marrëveshjet midis RSH-së dhe RI-së nuk përmbajnë ndonjë rezervë ligjore për mosekstradimin e personave të dënuar para hyrjes në fuqi të tyre.

7.2 Parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit nuk shtrihet ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare, por vetëm ndaj legjislacionit të brendshëm që parashikon vepra penale konkrete për veprime e mosveprime të caktuara të kundërligjshme, si dhe për llojin e masën e dënimin që parashikohet për



to, dispozita të cilat mund të ndryshohen me një ligj të mëvonshëm.

7.3 Sipas jurisprudencës kushtetuese, parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit duhet të respektohet nga gjykata kur fati i çështjes nuk është vendosur përfundimisht, çka nënkupton se ky parim nuk është i zbatueshëm në rastin konkret, nisur nga fakti se vendimet gjyqësore të gjykatave të huaja janë të formës së prerë dhe priten të ekzekutohen.

7.4. I pabazuar është edhe pretendimi në lidhje me zgjerimin e ekstradimit, pasi neni 501 i KPP-së i referohet situatës kur paraqitet një kërkesë e re nga autoriteti i huaj, ndërkohë që ka përfunduar procedura e ekstradimit të personit dhe ai është dorëzuar në shtetin e huaj, ndaj edhe gjykata e gjykon atë në mungesë. Në rastin konkret, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur bashkimin e të dyja kërkesave në të njëjtën fazë gjykimi, veprim i cili nuk ka pengesë ligjore, për sa kohë kërkuksi nuk është ekstraduar ende.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuksit

8. Kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, pasi pretendimet e tij përshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës; *ratione materiae*, pasi pretendimet janë *prima facie* në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese; *ratione temporis*, pasi ankimi individual kundër vendimit të Kolegjit Penal të datës 14.7.2016 është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 5.10.2016, duke respektuar afatin dyvjeçar të përcaktuar nga ligjit organik i Gjykatës Kushtetuese, i ndryshuar.

##### B. Për kërkesën e pezullimit të ekstradimit

9. Kërkuksi ka kërkuar pezullimin e ekstradimit të urdhëruar nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 23, datë 16.2.2016.

10. Gjykata, në seancën gjyqësore mbi bazë dokumentesh, mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e ekstradimit të paraqitur nga mbrojtësi i kërkuksit dhe vlerësoi se kjo kërkesë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 45, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Për rrjedhojë, ajo vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar.

##### C. Për pretendimin e cenimit të parimit të aksesit në Gjykatën e Lartë

11. Kërkuksi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se marrëveshja për ekstradimin konkurren me marrëveshjen dypalëshe me Italinë për njohjen e vendimeve penale të huaja mes dy vendeve dhe ekzekutimin përkatës në vendin e origjinës. Konkurrimi mes këtyre dy akteve, bazuar në nenin 29/3 të Kushtetutës, prodhon nevojën e përcaktimit se cili prej tyre është favorizues dhe në rastin konkret marrëveshja e cila mund të veprojë në dëm të kërkuksit është ajo e njohjes së vendimit penal, nëse ekzistojnë kushtet procedurale të nenit 514 të Kodit të Procedurës Penale.

12. Në lidhje me pretendimet e mësipërme, subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ato janë të pabazuara, duke argumentuar se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues nuk gjen zbatim ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare, por vetëm ndaj ligjit të brendshëm.

13. Bazuar në parimin *jura novit curia*, Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuksi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pavarësisht nga mënyra e formulimit të kërkesës, pretendimet e kërkuksit se Gjykata e Lartë edhe pse është ndodhur përpara kushteve të zbatimit të gabuar të ligjit nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit nuk e ka pranuar rekursin, duhet të trajtohen në këndvështrimin e respektimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë.

14. Gjykata ka pranuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të çdo individ për një proces të rregullt ligjor. Në këtë vështrim, Gjykata mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, që në parim u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të



rregullt ligjor. Në këto raste Gjykata analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, gjë që përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e kësaj Gjykate nuk është zgjidhja e një çështjeje konkrete, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë e individit është garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Në këtë kuptim, e drejta e individit për t'ju drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesin në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesin në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 67, datë*

17.11.2015; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes së të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 21, datë 24.7.2006; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata, në funksion të kontrollit të respektimit të standardit për akses në gjykim, rithekson se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29/3 të Kushtetutës, është një parim themelor që ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe si i tillë, është i rëndësishëm për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005; nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; se nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Kjo dispozitë kushtetuese reflektohet edhe në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet për një veprë që sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte veprë penale; ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese; kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale (*shih vendimin nr. 1, datë 20.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po ashtu, jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005; nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 84, datë 30.12.2016 të*



*Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 18, datë 14.4.2015; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Po ashtu, Gjykata konstaton se kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese për sa i përket zbatimit të garancive kushtetuese e procedurale penale, të cilat çojnë, sipas tij, në përkeqësimin e pozitës së tij duke i cenuar lirinë. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit, duke mos u shprehur dhe mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese.

21. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej mbi to në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit.

22. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se në çështjen konkrete Gjykata e Lartë ka lejuar një proces të parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës, duke mos ushtruar funksionin e saj kontrollues për respektimin e standardeve kushtetuese të procesit.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
  - Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2016-1269, datë 14.7.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
  - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar),  
Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari, Vitore Tusha

#### MENDIM PAKICE

Në çështjen me kërkuës Afrim Tarelli jam kundër qëndrimit të mbajtur nga shumica për arsyet e parashtruara në vijim:

1. Kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të tij, ka pretenduar se gjatë procesit të ekstradimit janë cenuar parimet kushtetuese që lidhen me zbatimin e ligjit penal favorizues. Në kërkesë argumentohet se përcaktimi i nenit 29 të Kushtetutës se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese bën që marrëveshja për ekstradimin të konkurrojë me marrëveshjen dypalëshe me Italinë për njohjen e vendimeve penale të huaja mes dy vendeve dhe ekzekutimin përkatës në vendin e origjinës. Në këtë kuptim, sipas kërkuësit, Gjykata Kushtetuese duhet të përcaktojë se cila prej dy marrëveshjeve të



lidhura midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në fushën penale është favorizuese për kërkuesin. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar se bashkimi i gjykimit të dy kërkesave të paraqitura nga pala italiane, përveçse përbën shkelle ligjore të karakterit procedural, bie ndesh edhe me parimin e specialitetit.

2. Shumica, bazuar në parimin *jura novit curia*, ka vlerësuar se pavarësisht nga mënyra e formulimit të kërkesës, pretendimet e kërkuesit se Gjykata e Lartë edhe pse është ndodhur përpara kushteve të zbatimit të gabuar të ligjit nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit nuk e ka pranuar rekursin, duhet të trajtohen në këndvështrimin e respektimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë. Sipas shumicës, kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese për sa i përket zbatimit të garancive kushtetuese e procedurale penale, të cilat çojnë, sipas tij, në përkeqësimin e pozitës së tij duke i cenuar lirinë. Bazuar në këtë arsytim shumica ka vendosur pranimin e kërkesës duke shfuqizuar vendimin dhe dërgimin e çështjes për rigjykim.

3. Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës, pasi, në vlerësimin tim, ai është marrë në kapërcim të kompetencave kushtetuese që kuadri kushtetues dhe ligjor i ka njohur kësaj Gjykate lidhur me vënien në lëvizje të gjykimit individual kushtetues mbi ankimin individual dhe jo kryesisht.

4. Shumica ka anashkalluar analizën e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku në lidhje me pretendimin e mbrojtësit të kërkuesit për konkurrimin midis marrëveshjes ekstraduese me shtetin italian dhe marrëveshjes dypalëshe për njohjen e vendimeve penale të huaja ajo arsyeton: *“Në rastin konkret objekt të shqyrtimit gjyqësor përbën kërkesa për lejimin e ekstradimit të shtetasit Afrim Zeneli alias Tarelli... do të përbënte objekt analize ligjore për sa kërkon mbrojtja vetëm në rastin eventual që objekt i shqyrtimit gjyqësor do të ishte dhe kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj për të njëjtin fakt, çka do të thotë se ky pretendim është sa alogjik dhe i pabazuar në ligj, në veçanti në dispozitat procedurale penale”*. Po ashtu, shumica nuk ka marrë parasysh se vendimi i Kolegjit Penal, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, edhe pse përmes një arsytimi të kufizuar, nga njëra anë, konfirmon ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankimuara,

pra mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta, dhe, nga ana tjetër, përputhshmërinë e këtij arsytimi me qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të shprehur në vendimin nr. 1, datë 30.1.2003, ku analizohen efektet e zbatimit të vendimeve penale me kufizim të lirisë të një të dënuari, si dhe të masave shtrënguese penale që kufizojnë lirinë e një personi në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara (konventat e Këshillit të Europës) dhe në Kodin e Procedurës Penale. Vlen të theksohet se praktika gjyqësore evidenton qartazi ndryshimet jo vetëm në procedurë, por edhe në qëllimin e dy formave të marrëdhënieve juridiksionale midis shteteve të ndryshme, *ekstradimi vs. njohja e vendimeve penale të huaja*. Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 *“Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”*, në nenin 52/2 parashikon se *“vendimi i një gjykate të huaj për dënimin me burgim mund të njihet: a) me kërkesë të shtetit dënues, kur personi i dënuar është shtetas shqiptar dhe ka vendbanim ose vendqëndrim në Shqipëri; dhe b) me kërkesën e një shtetasi shqiptar që vuan dënimin në shtetin dënues, për transferim dhe vazhdim të vuajtjes së dënimit në Shqipëri”*.

5. Në vështrim të sa më sipër, por edhe bazuar në natyrën ligjore të pretendimeve të kërkuesit, mendoj se në thelb, ato kanë të bëjnë me çështje të konstatimit dhe vlerësimit të provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Duke qenë çështje të natyrës ligjore dhe jokushtetuese, zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme për t'i dhënë përgjigje të arsyetuara, ashtu siç ka ndodhur edhe në rastin konkret.

6. Për sa më sipër, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Afrim Tarelli është e pabazuar dhe ajo duhej të ishte rrëzuar nga shumica.

Anëtare: Vitore Tusha

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë